



2023

RAPORTSTUDIMOR

VENDIMMARRJET E KOLEGJIT
ZGJEDHOR GJYQËSOR



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



**RAPORTI STUDIMOR MBI VENDIMMARRJET E
KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR**

(Analizë ligjore bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor)

Publikuar në Qershor 2024

Autor: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Përgatiti:

Dr. Heliona Miço, Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, Universiteti Epoka

Rishikimi ligjor:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Ky raport është hartuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të zbatimit të projektit *“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike: Forcimi i rolit monitorues dhe kërkesës së llogarisë nga qytetarët nëpërmjet shoqërisë civile, medias dhe mbështetjes akademike”*, financuar nga Ambasada Britanike në Tiranë dhe zbatuar në partneritet me Instituti i Studimeve Politike (ISP), Qëndresa Qytetare dhe BIRN Albania.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përcjell domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës Britanike.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

**Rr. Brigada e VIII, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10,
Tirana-Albania
PO BOX no.1752;
Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;
E-mail: office@ahc.org.al;
Web site: www.ahc.org.al**

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	6
HYRJE.....	7
I. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL VENDAS/ NDËRKOMBËTAR PËR ZGJEDHJET	8
1.1 Zgjedhjet e lira si një e drejtë kushtetuese/ ndërkombëtare	8
1.2 Administrata Zgjedhore	9
1.3 Regjistrimi i Zgjedhësve	10
1.4 Kandidatët në Zgjedhjet Vendore	11
1.5 Fushata Zgjedhore	12
1.6 Fondet Financiare	12
1.7 Media.....	14
1.8 Kuadri institucional	15
1.8.2 Formimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor	16
1.8.3 Subjektet zgjedhore që mund të vendosin në lëvizje KQZ/KLGJ	16
II. VENDIME TË KOLEGJIT ZGJEDHOR NË GRAFIKË	17
III. VENDIMET E KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR TË ANALIZUARA NË SHTRIRJE KOHORE	20
Lëvizja e Re (LRE) kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	20
<i>Vendim Nr.1, Dt. 23.02.2022</i>	<i>20</i>
Partia Lëvizja e Legalitetit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	20
<i>Vendim nr. 1, Dt. 09.03.2023</i>	<i>20</i>
Partia Bindja Demokratike kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	21
<i>Vendimi nr. 2, Dt. 09.03.2023</i>	<i>21</i>
Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar kundër Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	22
<i>Vendimi Nr. 3, Dt. 09.03.2023</i>	<i>22</i>
<i>Vendim nr. 4, Dt. 21.03.2023</i>	<i>22</i>
Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	23
<i>Vendimi Nr. 5, Dt. 27.03.2023</i>	<i>23</i>
Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	24
<i>Vendimi Nr.6, Dt. 30.03.2023</i>	<i>24</i>
Lodovik Hasan kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	25
<i>Vendimi Nr. 7, Dt. 05.04.2023</i>	<i>25</i>
Mehmet Nelaj kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	26
<i>Vendimi Nr. 8, Dt. 11.04.2023</i>	<i>26</i>
Partia “Nisma Thurje” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	27
<i>Vendimi Nr. 9, Dt. 13.04.2023</i>	<i>27</i>

Eduard Nallbani kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	28
<i>Vendimi Nr.10, Dt. 18.04.2023</i>	<i>28</i>
Partia Aleanca Progresiste (LZHK) e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	29
<i>Vendimi nr.11, Dt. 18.04.2023</i>	<i>29</i>
Partia e Unitetit Kombëtar kundër KAS	29
<i>Vendimi Nr. 12, Dt. 18.04.2023</i>	<i>29</i>
Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër KQZ.....	30
<i>Vendimi Nr. 13, Dt. 21.04.2023</i>	<i>30</i>
Koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’ kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	31
<i>Vendimi nr. 14, Dt. 21.04.2023</i>	<i>31</i>
Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	31
<i>Vendim Nr.15, Dt. 24.04.2023.....</i>	<i>31</i>
Partia Demokratike e Shqipërisë kundër KQZ.....	33
<i>Vendimi Nr.16, Dt. 24.04.2023</i>	<i>33</i>
Partia e Lirisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	35
<i>Vendimi Nr.17 Dt. 09.05.2023</i>	<i>35</i>
Partia e Lirisë Kundër Komisionit Qendror Të Zgjedhjeve	35
<i>Vendimi Nr. 18, Dt. 12.05.2023</i>	<i>35</i>
Bashkia Shijak kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	36
<i>Vendimi nr. 19 Dt.15.05.2023</i>	<i>36</i>
Dallëndyshe Bici, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	37
<i>Vendimi Nr.20, Dt. 18.05.2023</i>	<i>37</i>
Armando Subashi kundër Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve & Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisioni Qendror të Zgjedhjeve.....	38
<i>Vendimi nr. 21, Dt. 24.05.2023</i>	<i>38</i>
Gledian Llatja kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	38
<i>Vendimi Nr.22, Dt. 24.05.2023</i>	<i>38</i>
Majlinda Bufi kundër KAS & Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	39
<i>Vendimi nr. 23, Dt. 24.05.2023</i>	<i>39</i>
Safet Gjici kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	40
<i>Vendimi nr. 24, Dt.24.05.2023</i>	<i>40</i>
Partia “Lëvizja e Legalitetit” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	40
<i>Vendimi Nr.25 30.05.2023</i>	<i>40</i>
Lefter Maliqi; Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.....	41
<i>Vendimi Nr. 26, Dt. 07.06.2023</i>	<i>41</i>
Partia Aleanca Progresiste LZHK kundër Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	42
<i>Vendimi Nr.27, Dt.07.06.2023</i>	<i>42</i>

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” & Shkëlqim Hoxha kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	43
<i>Vendimi nr. 28, Dt. 15.06.2023</i>	<i>43</i>
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	53

SHKURTIME

DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
GN	Grupet e Numërimit
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Vendimit Penal
KAS	Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KZ	Kolegji Zgjedhor
KZAZ	Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor
RSH	Republika e Shqipërisë
KN	Komiteti Nismëtar
KRR	Komisioni Rregullator
KRIIK	Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara
KZGJ	Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit
KSHZ	Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
MB	Ministria e Brendshme
PL	Partia e Lirisë
PDK	Partia Demokratiane
PBDNJ	Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut
LRE	Lëvizja e Re
PDSH	Partia Demokratike e Shqipërisë
PEVN	Pajisjet Elektronike të Votimit dhe Numërimit
PS	Partia Socialiste
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
VNV	Vend i Numërimit të Votave

HYRJE

Zgjedhjet përcaktojnë nivelin e demokracisë në një shoqëri demokratike pasi ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e qeverisjes. Për këtë zhvillimi i tyre përbën një standard të rëndësishëm të legjitimitetit demokratik dhe zhvillimit të një vendi.¹ Rëndësia e tyre qëndron se në kushtet e demokracisë parlamentare mundësohet pjesëmarrja formale e shtetasve në ushtrimin e pushtetit.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë gur themeli i një shteti demokratik, duke promovuar stabilitetin politik, kohezionin social dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ato janë thelbësore për respektimin e parimeve të përfaqësimit, llogaridhënies dhe shtetit të së drejtës brenda shoqërisë.

E drejta e votës është një nga të drejtat themelore politike që gëzon individit. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa bërë dallime mbi baza shtresash apo përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike.²

Shprehja e vullnetit të individit nëpërmjet votës, ka si qëllim *përcaktimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike*, duke zgjedhur përfaqësuesit e popullit në organet e qeverisjes qendrore ose vendore, element që lidhet me interesin e përgjithshëm publik.

Zgjedhja e përfaqësuesve të popullit nëpërmjet një procesi zgjedhor ka rëndësi themelore në një shtet të së drejtës, pasi është edhe një nga format e ushtrimit të sovranitetit të popullit.³

Po ashtu edhe zgjedhja e përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore, kryhet në bazë të një procesi zgjedhor, që ka si bazë ushtrimin e së drejtës së votës nga zgjedhësit që kanë vendbanimin në njësinë administrative përkatëse.⁴ Për shkak të rëndësisë që ka procesi zgjedhor në një shoqëri demokratike, Kushtetuta e RSH ka përcaktuar në mënyrë të shprehur rregullimin e posaçëm ligjor të këtij procesi në ligjin për zgjedhjet.⁵

Në këtë raport janë marrë kryesisht në analizë zgjedhjet vendore të 14 majit 2023, ku zgjedhësit kanë votuar për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshilltarët për 61 bashkitë e Shqipërisë. Për këto zgjedhje janë regjistruar rreth 3,65 milion zgjedhës.⁶ Gjithsej 40 parti dhe koalicione me 144 kandidatë për kryetarë bashkie dhe rreth 23,700 kandidatë për këshilltarë kanë garuar në këto zgjedhje.

Raporti Studimor mbi Vendimmarrjet e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor bën një analizë ligjore të dispozitave të Kodit Zgjedhor, duke sjellë në vëmendje se një proces i drejtë zgjedhor siguron që të gjithë qytetarët të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në të. Gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare të 21 Prillit 2021, Zyra e OSBE për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) theksoi nevojën për rishikim të mëtejshëm të kuadrit ligjor për të

¹ Prezenca e OSBE-së, Vendime të Gjykatës Kushtetuese me objekt fushën e zgjedhjeve [1992-2015], Tiranë 2016
chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://www.osce.org/files/f/documents/c/e/304871.pdf

² vendimin nr. 11, datë 13.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese

³ Neni 2 i Kushtetutës së RSH në të cilin parashikohet shprehimisht se: "Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti".

⁴ Neni 109 i Kushtetutës në të cilën parashikohet shprehimisht se: "1. Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë".

⁵ Neni 68/2 i Kushtetutës parashikon se: "2. Në ligjin për zgjedhjet përcaktohen edhe kritere dhe rregulla të tjera të nevojshme për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre".

⁶ https://www.osce.org/files/f/documents/4/6/542511.pdf

adresuar rekomandimet e pa adresuara të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias, nëpërmjet një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës konsultimi, për t'u miratuar përpara zgjedhjeve të ardhshme. Garantimi i zgjedhjeve të lira që garantojnë fshehtësinë e votës mbetet ende një parim i porealizuar plotësisht, duke rekomanduar gjetjen e rrugëve për të parandaluar çdo formë presioni për të zbuluar nëse dikush ka votuar apo jo dhe si ka votuar. Në vazhden e rekomandimeve ishte edhe intensifikimi i përpjekjeve për të identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e shitblerjes së votës nga agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe inkurajimi i qytetarëve për të raportuar dhe dhënë prova për çdo rast të shitblerjes së votave apo të ushtrimit të presionit.

Në lidhje me zgjedhjet vendore të 14 Majit 2023 rekomandimet e ODIHR-it, nisur nga probleme të theksuara sa i përket blerjes së votës dhe përdorimit të mjeteve shtetërore në fushatë në nivel vendor dhe qendror, përfshijnë marrjen e masave ndaj keqpërdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe lokal, akuzave për blerje votash nga të gjitha anët, sigurimin e masave mbrojtëse për fshehtësinë e votimit dhe parandalimin e frikësimit të votuesve dhe presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit.

I. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL VENDAS/ NDËRKOMBËTAR PËR ZGJEDHJET

1.1 Zgjedhjet e lira si një e drejtë kushtetuese/ ndërkombëtare

Në Republikën e Shqipërisë, zgjedhjet vendore rregullohen nga:

- Kushtetuta e RSH (1998) - Në pjesën e parë të Kushtetutës së RSH, parashtrohen parimet themelore dhe konkretisht në nenin 1/3 të Kushtetutës parashikohet: *Qeverisja bazohet në një sistem zgjedhësh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike.*
- Kodi Zgjedhor, i vitit 2008, i ndryshuar - Kodi Zgjedhor shërben si një bazë e përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Rregullimi ligjor i procesit zgjedhor në tërësi dhe në elementë të veçanta të tij, rregullohet nga ky Kod, i cili përbën ligjin organik specifik të zbatueshëm në lidhje me të gjitha pretendimet e rregullshmërisë së procesit zgjedhor.

Të dy këto akte të rëndësishme, të cilat kanë epërsi në piramidën e akteve normative të RSH, janë ndryshuar për herë të fundit në vitin 2020. Si rrjedhojë dispozitat e reja ligjore, që lidhen me administrimin zgjedhor, financimin e fushatës dhe masat mbrojtëse kundër abuzimit me burimet publike, u zbatuan për herë të parë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

Midis akteve të tjera normative të zbatueshme në çështjet e administrimit zgjedhor dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore mund të përmendim:

- Kodin e Procedurës Administrative;
- Kodin e Procedurës Civile;
- Ligjin për Partitë Politike (2000);
- Ligjin për Garantimin e Integritetit të Personave të Zgjedhur, të Emëruar ose që Ushtrajnë Funksione Publike (2015);⁷
- Ligjin për Tubimet (2001);
- Ligjin për Barazinë Gjinore (2008);

⁷ Ligji I ashtuquajtur ligjit i Dekriminalizimit.

- Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (2008);
- Aktet rregulluese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).⁸

Po ashtu Shqipëria është *palë e organizmave të specializuar të Këshillit të Evropës dhe konventave të ratifikuara në kuadër të aderimit pranë këtij Këshilli* që lidhen me zgjedhjet demokratike dhe të drejtat e njeriut dhe është anëtare e:

- Komisionit të Këshillit të Evropës për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO);
- Këshillit të Evropës, përmes ratifikimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në këtë Konventë parashikohet e drejta për zgjedhje të lira në nenin 3 të Protokollit nr. 1:

“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”

Në një mënyrë të përgjithshme, në fushën e zbatimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1 nuk hyjnë zgjedhjet vendore, qofshin ato bashkiake⁹; ose rajonale.¹⁰ Gjykata ka gjykuar në fakt se pushteti për të nxjerrë rregullore dhe akte administrative, e cila u njihet autoriteteve vendore në shumë vende, dallon nga pushteti ligjvënës që ka parasysh neni 3 i Protokollit nr. 1, edhe pse pushteti ligjvënës nuk duhet të kuptohet medoemos sikur ka të bëjë vetëm me parlamentet kombëtare (Mólka k. Polonisë).¹¹

1.2 Administrata Zgjedhore

Zgjedhjet vendore të 14 majit u menaxhuan nga një administratë zgjedhore me tre nivele:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
2. 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor;
3. 5211 Komisione të Qendrave të Votimit.

Numërimi u krye nga Grupet e Numërimit në 92 Vende të Numërimit të Votave.

Për zgjedhjet lokale të 14 majit 2023, KZAZ-të u ngritën më 12 shkurt dhe kishin përgjegjësi për zhvillimin e zgjedhjeve në zonat e tyre zgjedhore përkatëse,¹² të cilat përbëheshin nga 7 anëtarë dhe 1 sekretar pa të drejtë vote, të emëruar nga shumica parlamentare dhe opozita.¹³ Partitë politike mund të tërhiqnin ose zëvendësonin anëtarët e komisioneve të tyre sipas gjykimit të tyre dhe pa justifikim.¹⁴

⁸ Aktet e KQZ plotësojnë legjislacionin lidhur me zgjedhjet.

⁹ *Xuereb k. Maltës, Vendim nr. 52492/99, 15.06.2000 dhe Salleras Llinares k. Spanjës, vendim nr. 52226/99, 12.10.2000*

¹⁰ *Malarde k. Francës, vendim nr. 55093/13, 17.06.2021*

¹¹ [Udhëzues rreth nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, E drejta për zgjedhje të lira](#), fq. 5

¹² Bashkitë me mbi 80.000 zgjedhës të regjistruar ndahen nga KQZ-ja në më shumë se një Zonë Zgjedhore. Për këto zgjedhje, 50 nga 92 KZAZ-të janë në përputhje me bashkinë përkatëse dhe merren me regjistrimin e kandidatëve dhe akreditimin e vëzhguesve partiakë. Për 11 bashkitë e mbetura, regjistrimi i kandidatëve dhe akreditimi i vëzhguesve partiakë janë kryer nga KQZ-ja

¹³ Tre anëtarë të KZAZ-së emërohen nga shumica parlamentare dhe tre nga opozita parlamentare (dy nga partia kryesore opozitare/në pushtet dhe një nga partia e dytë e shumicës/opozitës parlamentare). Anëtar i shtatë propozohet nga PS në KZAZ-të me numër çift dhe nga PD në KZAZ-të me numër tek. Kryetari i KZAZ-së përfaqëson partinë që ka emëruar anëtarin e shtatë, ndërsa nënkryetari është i përkatësisë së kundërt. Sekretari propozohet nga subjekti politik që emëron zëvendëskryetarin.

¹⁴ Seksioni II.3.1.f i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias 2002, thotë se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t'i shkarkojnë ata sipas dëshirës"

Seancat e KZAZ-ve janë publike dhe vendimet e tyre publikohen në ambientet e tyre ose vihen në dispozicion sipas kërkesës. KQV-të përbëhen në të njëjtën mënyrë si KZAZ-të. Ligji parashikon që qendrat e votimit të vendosen në ambiente të aksesueshme.

KQZ-ja pilotoi një votim elektronik në bashkitë **Elbasan, Kamzë dhe Vorë**, duke mbuluar 401 QV.¹⁵ Për herë të parë në Shqipëri, pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik u eksperimentuan në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 dhe më pas në zgjedhjet vendore të 14 majit 2023. Duke j'u referuar përmbajtjes së *vendimin nr. 30, dt. 19.06.2023 dhe vendimin nr. 32, dt. 20.06.2023, Koalicioni "Bashkë Fitojmë" kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*, ka kontestuar zgjedhjet me objekt: (i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Kamzë/Elbasan; dhe (ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamzë/ Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike. Lidhur me këto dy raste, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerësoi se, kërkimi i palës paditëse për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Kamzë/Elbasan, për shkak të shkeljeve në votimin elektronik, është i pabazuar në ligj, pasi nuk u arrit të vërtetohet se mosplotësimi i njërit prej kushteve teknike të Pajisjes Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN), cenoi procesin zgjedhor dhe aq më tepër nuk u provua që kjo shkelje të ketë qenë e tillë, sa të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

1.3 Regjistrimi i Zgjedhësve

Shtetasit e moshës 18 vjeç e lart, në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë, me përjashtim të atyre që janë konstatuar si të paaftë me vendim gjykate, gjë e cila bie ndesh me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar.¹⁶ E drejta e votës pezullohet edhe për shtetasit që vuajnë dënimin me burg për kryerjen e disa krimeve të caktuara.¹⁷

Regjistrimi i zgjedhësve është pasiv dhe i decentralizuar. Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile dhe mbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme. Hartimi i listave të zgjedhësve dhe përfshirja e tyre në lista në bazë të kriterit të vendbanimit është bërë objekt gjykimi në vendimin nr. 28, datë 15.06.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerësoi të përligjura vetëm një pjesë të pretendimeve të palës paditëse e që lidhen në thelb me pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit Nr.2224/1 të ZAZ Nr.43, Bashkia Rrogozhinë. Ndryshimi i listës së zgjedhësve, në rastin konkret, në lidhje me vendbanimin e tyre, ka tejkaluar afatin ligjor jo më vonë se 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. Këta zgjedhës edhe nëse paraqesin kërkesë në gjykatë për të saktësuar vendbanimin pas shpalljes së listës së zgjedhësve, lista nuk ndryshon.

¹⁵ Çdo qendër votimi në këto tre bashki do të pajiset me dy makineri. Në total, KQZ ka prokuruar 828 pajisje votimi elektronike. Fletët e votimit në letër do të jenë të disponueshme në qendrat e votimit si rezervë, në rast të mosfunksionimit të pajisjeve.

¹⁶ Neni 29 i Konventës së 2006 për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK) kërkon që shtetet palë "t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët". Shih gjithashtu paragrafin 48 të Komentit të Përgjithshëm Nr.1 të nenit 12 të KDPK. Paragrafi 7.3 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990 parashikon që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së do t'u garantojnë të drejtën e votës universale dhe të barabartë qytetarëve të rritur". Bashkëbiseduesit e MVZ-së të ODIHR-it vunë në dukje se në praktikë, shumë pak zgjedhës janë të privuar nga kjo e drejtë për shkak të paaftësisë mendore, intelektuale apo psiko-sociale

¹⁷ Ligji për Dekriminalizimin pezullon të drejtat e votës për kryerjen e krimeve të renditura në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke filluar nga veprat e lidhura me zgjedhjet deri te krimet e rënda).

Zgjedhësit mund të verifikonin të dhënat e tyre duke përdorur një sërë mënyrash deri më 4 prill,¹⁸ dhe pas kësaj date ndryshimet mund të kërkoreshin përmes gjykatës së rrethit, deri në 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve.¹⁹ Identifikimi i zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve u krye me pajisje elektronike të identifikimit offline që përmbanin listat e zgjedhësve të të gjitha qendrave të votimit. Zgjedhësit duhet të ishin të pajisur me karta identiteti ose pasaporta biometrike për të verifikuar identitetin e tyre dhe gjurmët e gishtave të tyre skanoheshin në vend të një nënshkrimi për të konfirmuar se ata janë identifikuar.²⁰

1.4 Kandidatët në Zgjedhjet Vendore

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të garojë për zgjedhjet vendore, përveç atyre që vuajnë dënimin me burgim ose janë dënuar për një kategori të caktuar krimesh ose janë në kërkim, si dhe ata që mbajnë pozicione publike të papajtueshme me statusin e kandidatit.²¹

Partitë dhe koalicionet politike duhet të regjistrohen në KQZ si subjekte zgjedhore përpara dorëzimit të listave të kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe kryetarëve të bashkive.²²

Një kandidat mund të paraqitet vetëm në një listë dhe renditja në listën e kandidatëve nuk mund të ndryshohet pas regjistrimit.

Partitë dhe koalicionet politike, të cilat nuk janë të përfaqësuara në parlament ose në këshillat bashkiakë përkatës, si edhe kandidatët e pavarur, duhet të dorëzonin firmat mbështetëse të jo më pak se 1% të zgjedhësve të regjistruar në bashki.²³

Sipas ligjit, administrata zgjedhore verifikon 5% të firmave të depozituara. Kandidaturat verifikohen në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Dekriminalizimin.²⁴

Në zgjedhjet vendore të 14 majit për 61 pozicione për kryetar bashkie dhe 1,603 pozicione për anëtarë këshilli, duke përfshirë 2 kandidatë të pavarur për kryetar bashkie dhe 10 për këshillat bashkiakë garonin:

- 40 parti dhe koalicione;
- 144 kandidatë për kryetar bashkie;

¹⁸ Zgjedhësit mund të kontrollojnë të dhënat e listës së tyre të zgjedhësve duke përdorur aplikacionin e KQZ-së ose portalet online në e-albania. Ekstrakte të listës së zgjedhësve janë publikuar nga njësi zgjedhore.

¹⁹ Listat e zgjedhësve iu shpërndanë KZAZ-ve deri më 9 prill dhe listat përfundimtare të zgjedhësve u publikuan menjëherë më pas. Lista përfundimtare e votuesve përfshin 1,843,170 zgjedhës meshkuj dhe 1,807,380 femra.

²⁰ KQZ ka vendosur kritere të reja për identifikimin e zgjedhësve, për të adresuar tentativat e mundshme për vjedhjen e identitetit. Zgjedhësit do të kenë mundësi deri në tre tentativa për t'u identifikuar me anë të gishtit të madh dhe tregues. Nëse kjo dështon, ata do të duhet të nënshkruajnë listën e zgjedhësve dhe printimin nga pajisja, në mënyrë që të lejohen të votojnë.

²¹ Ligji për Dekriminalizimin i referohet dëbimit nga një shtet anëtar i BE-së, Australisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara. Ligji, gjithashtu, referon qytetarët e dënuar për krime të caktuara, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, si dhe ata për të cilët ka një urdhër për kërkim ndërkombëtar. Gjyqtarët, prokurorët, oficerët e ushtrisë, policisë dhe sigurimit kombëtar, personeli diplomatik, prefektët, anëtarët e komisioneve zgjedhore, Presidenti i Republikës dhe zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj, duhet të japin dorëheqjen që të kenë të drejtë të kandidojnë.

²² Partitë duhet të dorëzojnë dokumentacionin për regjistrim deri më 6 mars dhe koalicionet deri më 15 mars.

²³ Partitë politike që nuk kanë përfaqësim në parlament ose në këshillat vendore duhet të dorëzojnë jo më pak se 50 por jo më shumë se 3000 nënshkrime mbështetëse, pavarësisht nga lloji i zgjedhjeve. Ndërsa, kandidatët e pavarur për zgjedhjet vendore duhet të dorëzojnë nënshkrimet e zgjedhësve të barabartë me 1% të votuesve të regjistruar në bashkinë përkatëse, pavarësisht nga madhësia e saj. Kandidatit të pavarur Eduard Nallbani iu refuzua regjistrimi për shkak të nënshkrimeve të pamjaftueshme të mbështetësve dhe pragu për bashkinë e Tiranës është përcaktuar me 7,000 zgjedhës.

²⁴ KQZ-ja dhe 50 KZAZ-të verifikojnë që kandidatët kanë të drejtë të kandidojnë dhe KQZ-ja verifikon që kandidatët përmbushin kriteret ligjore për integritetin, pra, që nuk janë dënuar ose nuk janë nën hetim për vepra penale të caktuara. Nëse është i nevojshëm një hetim i mëtejshëm, ata i referojnë kandidatët në Prokurorinë e Përgjithshme.

- 23,700 kandidatë për këshillat bashkiakë.²⁵

1.5 Fushata Zgjedhore

Fushata zgjedhore nisi zyrtarisht në datën 14 prill 2023 dhe përfundoi një ditë përpara zgjedhjeve, më 12 maj 2023. Fushata në objektet publike është e ndaluar.²⁶ **Vendimi Nr. 9 i KQZ, i vitit 2020** ndalon aktivitetet politike nga nëpunësit publikë gjatë orarit të punës. KQZ-ja është e autorizuar të shqyrtojë me kujdes të gjitha veprimtaritë e institucioneve publike për të identifikuar abuzimin e burimeve publike dhe të ndalojë veprimtaritë që nuk janë në përputhje me ligjin. Zbatimi i këtyre parashikimeve ligjore në praktikë është bërë objekt gjykimi i Kolegjit Zgjedhor me anë të të **Vendimit Nr.20, dt. 18.05.2023**. Sipas këtij vendimi **Dallëndyshe Bici, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, e cila është denoncuar pranë KQZ nga Qendra “Qëndresa Qytetare” duke pretenduar se ka shpërdoruar burimet publike. Sipas denoncimit pretendohet se: “Më datë 16 prill 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi”, në fshatin Fshat është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj bashkie, z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit Fshat.” Në kushtet, kur procedura administrative e ndjekur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillimisht dhe më pas Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, i referohet një personi të tretë, jo subjekt zgjedhor, Kolegji ka konstatuar mungesë kompetence lëndore dhe pushimin e gjyqimit. Dhe në rastin e padisë së paraqitur nga **Safet Gjici kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi nr. 24, 24.05.2023**, Kolegji ka vendosur mbi pushimin e çështjes pasi subjekti zgjedhor z. Gjici nuk është paraqitur në gjykim pa shkaqe të justifikuar, duke reflektuar mungesë interesi për gjykimin. Në lidhje me rastin e Dallëndyshe Bici, është e nevojshme të theksohet domosdoshmëria për të interpretuar nga gjykata rastin e saj, në frymën e parimeve kushtetuese dhe atyre të Kodit Zgjedhor lidhur me paanshmërinë e zyrtarëve publikë për të mos përdorur pozicionet e tyre për të ndikuar në mënyrë të padrejtë në zgjedhje. Nga ana tjetër është e nevojshme përcaktimi i detajuar i kufizimeve që mund të kenë drejtorët e përgjithshëm të institucioneve publike qeveritare, në përfshirjen e tyre në fushatat elektorale, të cilat mund të përfshijnë kufizime në përdorimin e burimeve qeveritare për qëllime fushate, ndalime për përfshirjen në aktivitete politike partiake gjatë kohës që janë në detyrë dhe kërkesat për të marrë leje ose dorëheqje nga pozicionet e tyre nëse dëshirojnë të marrin pjesë aktive në një fushatë.

1.6 Fondet Financiare

Garuesit mund ta financojnë fushatën me fonde publike dhe private. Parimi i transparencës së financimit të partive politike, parashikohet fillimisht në nenet 15/1 e vijues të ligjit “Për partitë politike”. Në nenin 15/2 përcaktohet se: “1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive, sipas rregullave të këtij ligji. 2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve: d) vendos sanksione kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji”. Me ndryshimet që iu bënë këtij ligji në vitin 2020, në të njëjtën kohë kur pësoi ndryshime edhe Kodi Zgjedhor, një pjesë e dispozitave që lidheshin me financimin e

²⁵ Mbështetur në të dhënat e KQZ-së, tre partive dhe shtatë grupeve të votuesve iu refuzua regjistrimi për shkak të dokumentacionit jo të plotë. Tre kandidatë për kryetar bashkie dhe 10 kandidatë për këshilltarë vendorë u tërhoqën pasi ishin regjistruar. KQZ-ja më 18 prill 2023 rivendosi kandidatin për kryetar bashkie të Nismës Thurje në Dropull (Qarku i Gjirokastrës), pas vendimit të Kolegjit Zgjedhor.

²⁶ Këto ndalime rregullohen nga Kodi Zgjedhor, Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike dhe Ligji për Shërbimin Civil.

fushatës zgjedhore, u shfuqizuan në ligjin “Për partitë politike” dhe u bënë pjesë e Kodit Zgjedhor dhe konkretisht në nenin 3, pika 5/1.

Në 12 prill 2023, KQZ ndau 345,341, 079 lekë (rreth 3.07 milion Euro) të fondit vjetor publik, parashikuar nga Ligji për Partitë Politike, tek 11 partitë që garuan në zgjedhjet e fundit parlamentare.²⁷ Partitë politike që morën të paktën 1% të votave në zgjedhjet e fundit vendore kualifikohen të marrin fonde publike shtesë, parashikuar në Kodin Zgjedhor. Parlamenti caktoi 100 milion lekë për fushatën e zgjedhjeve lokale. Në mbështetje të kësaj, KQZ vendosi në 22 prill, të ndajë rreth 97 milion lekë tek 13 subjekte zgjedhore.²⁸ Kandidatët e pavarur nuk përfitojnë nga fondet publike.

Në raportin përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve vendore të 14 Majit 2023, KShH rekomandoi rishikimin e ligjit nr. 8580, dt. 17.02.2002, konkretisht në nenin 19/2, i cili parashikon shpërndarjen e ndihmës financiare për partitë politike, duke vendosur që partitë plotësuese të njërit prej kritereve të përcaktuara në ligj, të mos mundet që të jenë gjithashtu përfituese nën kriteret e tjera. KShH rekomandoi që kjo dispozitë të parashikojë kritere të qarta dhe objektive që mundësojnë një shpërndarje më të drejtë e proporcionale të fondeve publike midis partive politike²⁹.

Fondet private mund të përbëhen nga burime vetjake të garuesit, dhurime nga qytetarët shqiptarë dhe personat juridikë dhe kreditë bankare. Dhurimet, përfshirë dhe dhurimet në natyrë, janë të kufizuara deri në 1 milion lek (rreth 8,850 Euro).³⁰

Shpenzimet totale të fushatës për një parti nuk duhet të tejkalojnë 300%, dhe ato të kandidatit të pavarur 50%, të masës më të lartë të fondit publik të shpërndarë për një parti, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të fundit vendore. Meqenëse këto fonde u përcaktuan më 22 prill, kufiri i shpenzimeve u bë i njohur për garuesit pasi fushata kishte filluar. Çdo garues duhet të regjistronte çdo dhurim që merrte, si dhe të dhëna identifikimi të dhuruesve, në një regjistër të veçantë të miratuar nga KQZ. Garuesve nuk u kërkohet të nxirrin publikisht, përpara ditës së zgjedhjeve, burimin dhe vlerën e fondeve të mbledhura, por duhet të dorëzonin raporte financiare brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar. Kodi Zgjedhor paraqet një listë sanksionesh për shkeljet financiare gjatë fushatës.

Vendimet që lidhen me anashkalimin e detyrimit për raportimin financiar nga partitë politike i përkasin zgjedhjeve të Kuvendit të 25 prillit 2021. Vendimi i parë ka si palë paditëse Partinë Lëvizja e Legalitetit kundër KQZ (e paditur). Përkatesisht, në vendimin e parë **nr. 1, 09.03.2023**, Kolegji ka vendosur se paditësi, si parti politike nuk mund të anashkalonte detyrimet për raportimin financiar sipas Kodit Zgjedhor, duke mos i përmbushur ato, thjesht me justifikimin se ishte detyrim i partisë udhëheqëse të koalicionit. Përgjatë analizës së këtij vendimi, mendojmë se ka pasaktësi në dispozitat e Kodit Zgjedhor, sa i takon të drejtës së

²⁷ Nga këto PS ka marrë rreth 151.5 milionë lekë, PD 106.4 milionë, Partia e Lirisë 15.5 milionë, PSD 12.3 milionë, Partia Republikane (PR) 11.5 milionë lekë, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) 9.8. milionë, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), Partia Agrare Ambientaliste (PAA), Partia e Aleancës Progresive (PAP) dhe Partia Lëvizja e Legalitetit (PLL) 8.0 milionë secila dhe Nisma Thurje (NTH) 6.3 milionë. 1 euro është afërsisht 113 lekë.

²⁸ Në datën 20 prill, qeveria miratoi një vendim për “Marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve administrative gjatë procesit zgjedhor”, në të cilin ngriti një task forcë *ad hoc* për koordinimin e procesit të monitorimit, e përbërë prej 11 ministrave dhe zyrtarëve shtetërorë, me përfaqësues të katër institucioneve të tjera, përfshirë KQZ-në dhe Prokurorinë e Përgjithshme.

²⁹ Raporti-Perfundimtar-per-Monitorimin-e-Zgjedhjeve_19-Shtator-2023.pdf (ahc.org.al), fq.28

³⁰ Personat juridikë që kanë përfituar fonde prokurimi publik mbi 10 milionë lekë (afërsisht 88 500 euro), ata që janë përfshirë në projekte të partneritetit publik ose kanë borxhe ndaj buxhetit të shtetit, si dhe ata që ushtrojnë veprimtari në lidhje me median; nuk lejohen të dhurojnë për fushatat elektorale. Të gjitha donacionet mbi 50,000 lekë (afërsisht 440 euro) duhet të bëhen përmes një llogarie bankare të caktuar

ankimit në gjykatë, pasi është përdorur referencë e gabuar ligjore. Konkretisht neni 145/2 i Kodit i referohet shkronjave “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të Kodit, lidhur me përjashtimin që u lind subjekteve zgjedhore për të bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mos marrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në rastin konkret neni 24 nuk parashikon në përmbajtjen e tij shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç”, dispozitë e cila sjell paqartësi ligjore.

Në vendimin e dytë, Nr. 2, dt. 09.03.2023, paditësi partia Bindja Demokratike ka kërkuar pranë KZGJ anulimin e vendimit të KAS nr. 07, datë 25.01.2023, nëpërmjet të cilit është vendosur sanksioni administrativ për shkelje në lidhje me raportimin financiar ndaj këtij subjekti zgjedhor në masën 500,000 lekë, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor. Kolegji ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ndërsa **në vendimin e tretë, Nr. 3, dt. 09.03.2023 kërkesa e partisë politike “Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar”** për ndryshimin e Vendimit të KAS nr. 07, datë 25.01.2023, me anë të të cilit është vendosur sanksioni administrativ gjobë në masën 500,000 lekë për shkelje lidhur me raportimin financiar nuk është pushuar nga KZGJ dhe dërguar për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Përkundrazi, KZGJ ka dalë në vendimmarrje duke lënë në fuqi vendimin e KAS për vënien e masës administrative ndaj subjektit zgjedhor.

Sikurse vihet re edhe më sipër, Kolegji ka mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje me objekt të ngjashëm. Vihet re që vijon të jetë e paqartë gama e çështjeve që i përkasin procesit zgjedhor dhe që janë në kompetencë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, në veçanti ato me natyrë financiare. Interpretimi i ligjit në mënyra të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve me objekt ngjashëm, herë duke dalë në vendimmarrje vetë KZGJ, herë duke dërguar aktet për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çon në vendime dhe jurisprudencë të paqëndrueshme. Për këtë qëllim është e nevojshme të saktësohen në Kodin Zgjedhor gama e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë një procesi zgjedhor që i ka kompetencë për t’i shqyrtuar Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.

1.7 Media

Kodi Zgjedhor rregullon mbulimin e fushatës të transmetuar nga mediat, të cilat duhet të ofrojnë raportim të paanshëm dhe të balancuar. Kodi përmban gjithashtu dispozita që synojnë nxitjen e transparencës për reklamat zgjedhore dhe raportet e monitorimit të medias. Televizioni, thënë ndryshe media tradicionale mbetet burimi kryesor i informacionit politik. Megjithatë, përdorimi i mediave online gjatë këtyre zgjedhjeve dhe jo vetëm vijon të rritet më mënyrë të vazhdueshme.

Në vendimet e Kolegjit ka një sërë çështjesh që lidhen konkretisht me fushatat e bëra përmes mediave **online** dhe përdorimi i **hashtageve** nga vetë kandidatët. Në këtë analizë janë evidentuar **4 vendime të cilat lidhen me vendosjen e gjobave kundrejt kandidatëve të cilët gjatë fushatave zgjedhore kanë përdorur faqet zyrtare të institucioneve publike në rrjetet e ndryshme sociale** (Facebook, Twitter, Instagram etj.) që bëjnë pjesë në kategorinë “asete”, në kuptim të nenit 91/2 të Kodit Zgjedhor, pra ato janë “burime” të institucionit në kuptim të kësaj dispozite. Kjo do të thotë se faqet zyrtare të bashkive në rrjetet e ndryshme sociale të sipërcituara, nuk mund të përdoren ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje. Një nga vendimet e KZ Nr. 19 15.05.2023 rastet ka qenë, **Bashkia**

Shijak kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku në vendimin është vendosur pushim i padisë, në kushtet që Bashkia Shijak, nuk legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi nuk ka interes të ligjshëm për paraqitjen e saj, por legjitimimi i takon personalisht Kryetarit të Bashkisë.

Vendimi nr. 21, 24.05.2023, Armando Subashi kundër Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve & Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ, z. Subashi nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 24.05.2023. Pavarësisht marrjes dijeni rregullisht, z. Subashi nuk i bëri me dije Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, shkaqe që përligjinin mosparaqitjen e tij në seancën gjyqësore. Neni 179 i Kodit të Procedurës Civile i ndryshuar, parashikon pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ... dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”. Rrjedhimisht, KZ vendosi pushimin e këtij gjykimi.

Vendimi Nr.22, datë 24.05.2023, Gledian Llatja kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor konfirmon qëndrimin e KAS, se: “9. Kandidatët për kryetar bashkie të ngarkuar me përgjegjësi sipas vendimit nr. 441, datë 05.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, gëzojnë status të dyfishtë, si kandidatë dhe si kryetarë në detyrë të bashkive përkatëse.” Si kryetar të bashkive, personat në fjalë kanë akses, dijeni dhe përgjegjësi për postimet në faqen zyrtare të bashkive që ato drejtojnë. Ato kanë të gjithë pushtetin e nevojshëm ligjor për të urdhëruar ndërprerjen e shkëljes së ligjit dhe për të marrë masa që kjo sjellje të mos përsëritet. Fakti që ata nuk e kanë ushtruar këtë pushtet deri ditën e urdhërimit nga Komisioneri do të thotë se ata duhet t’i nënshtrohen, në cilësinë e subjektit zgjedhor, veprimit të sanksionit të parashikuar nga neni 172/1 i Kodit Zgjedhor. Kolegji e rrëzoi padinë si të pabazuar në ligj e prova.

Ndërsa në *Vendimin nr. 23, datë 24.05.2023, Majlinda Bufi kundër KAS & Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*, çështja e paraqitur nga kryetarja e Bashkisë Roskovec, me objekt kundërshtimin e sanksionit administrativ nga KAS, për mungesë të kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor dhe dërgimin në kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është pushuar.

Vihet re që për çështjen me palë paditëse Majlinda Bufi, kolegji ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga zgjidhja që i është dhënë dy çështjeve të tjera me të njëjtin objekt (çështjes me padi të ngritur nga A. Subashi dhe asaj me padi të ngritur nga G. Llatja). Të dyja paditë e fundit janë rrëzuar dhe ka mbetur në fuqi vendimi i KAS, ndërsa për çështjen me palë paditëse Majlinda Bufi është vendosur pushimi i çështjes dhe dërgimi i akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. Interpretimi i ligjit në mënyra të ndryshme, çon në vendime dhe jurisprudencë jo solide dhe të paqëndrueshme. Dhe kjo tregon që vendimet e ndryshme gjyqësore, për çështje me me objekte dhe natyrë të ngjashme, nxjerrin në dritë mospërputhje apo probleme brenda sistemit juridik, pasi është gjykata ajo që i jep jetë zbatimit të ligjit. Për këtë qëllim është e nevojshme të saktësohen në Kodin Zgjedhor gama e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë një procesi zgjedhor që i ka kompetencë për t’i shqyrtuar Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.

1.8 Kuadri institucional

Kodi Zgjedhor ka parashikuar të drejtën e ankimit drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor për procese dhe subjekte të ndryshme. E drejta e ankimit i njihet si subjekteve zgjedhore, interesat ligjore të të cilëve preken nga vendimmarrja e KQZ, po ashtu edhe palëve të treta. Ndërkohë

që zgjedhësit mund të ankohen vetëm në lidhje me përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve dhe vëzhguesit mund të ankimojnë vetëm refuzimin e akreditimit të tyre, kushdo mund të paraqesë raportime lidhur me shkeljet e pretenduara në KQZ, përfshirë elektronikisht në faqen e internetit të KQZ-së.

1.8.2 Formimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor përbëhet nga 8 gjyqtarë të përzgjedhur me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga radhët e gjyqtarëve³¹ që kanë kaluar me sukses, me vendim të formës së prerë, procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, sipas ligjit nr. 84/2016,. Ky organ gjykon ankimet e bëra nga subjektet zgjedhore kundër vendimeve të KQZ-së.

Kuorumi për gjykimin në gjykatë parashikohet në nenin 155/2:

*Kolegji Zgjedhor gjykon me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë. Relatori i çështjes kryeson trupin gjykues.*³²

Vendimi i palës/palëve që ka paraqitur padinë, duhet të dëgjohet drejtësisht, të jepet publikisht nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur e krijuar me ligj duke respektuar afatet ligjore.

1.8.3 Subjektet zgjedhore që mund të vendosin në lëvizje KQZ/KLGJ

Në bazë të Kodit Zgjedhor, subjekte zgjedhore janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod.³³

Subjekteve zgjedhore u njihet **e drejta e ankimit në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë** kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.³⁴

Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.³⁵

Kolegji Zgjedhor gjykon dhe vendos për kërkesëpaditë brenda një afati të arsyeshëm, brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesëpadisë. Për vendime që KQZ merr jashtë periudhës e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje³⁶, Kolegji Zgjedhor vendos brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankimit.

³¹ Nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

³² Neni 155, pika 2, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

³³ Neni 2, pika 20, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

³⁴ Neni 145, pika 1, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

³⁵ Neni 152, pika 2, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

³⁶ Neni 157, pika 2, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar


Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:

- a) pushimin e gjykimit;
- b) gjykimin e çështjes në themel; ose
- c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.³⁷

Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.³⁸

II. VENDIME TË KOLEGJIT ZGJEDHOR NË GRAFIKË

Përmes këtij raporti studimor është bërë një analizë ligjore e 36 vendimeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në grafikun në vijim, pasqyrohen të dhëna lidhur me këto vendime, subjektet zgjedhore/palët e 3-ta që kanë paraqitur padi si dhe ndarja e zgjedhjeve respektivisht atyre që i përkasin zgjedhjeve të pjesshme vendore të vitit 2022 dhe 2023, zgjedhjeve parlamentare të dt. 25 prill 2021, dhe zgjedhjeve të përgjithshme për organet e qeverisjes vendore të dt. 14 maj 2023.



Grafiku nr. 1 – Zgjedhjet e Kuvendit, Zgjedhjet vendore dhe zgjedhjet e pjesshme vendore


Në vendimet e Kolegjit të pasqyruar në grafikun nr. 1 gjejmë rastet lidhur me:

- a) Zgjedhje të pjesshme të mbajtura në datën 6 mars 2022. Lidhur me këto zgjedhje, është trajtuar një vendimarrje e Kolegjit.
- b) Zgjedhje të pjesshme të mbajtura në datën 24 shtator 2023, për Kryetar të Bashkisë Kukës. Lidhur me këtë proces, dy janë vendimet e analizuara, të cilat zënë 5% të saj.
- c) Zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit datë 25 prill 2021. Janë studiuar 4 vendimarrje që lidhen me përdorimin e fondeve dhe transparencën në lidhje me raportet financiare të cilat përbëjnë 11% të rasteve të marra në analizë.

³⁷ Neni 158, pika 1, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar


³⁸ Neni 158, pika 5, ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

d) Zgjedhje për organet e qeverisjes vendore datë 14 maj 2023. Numrin më të madh të vendimmarrjeve të trajtuara, 29 të tilla ose 81% e totalit, në këtë analizë e përbëjnë çështjet që lidhen me zgjedhjet vendore të vitit 2023.



Grafiku nr. 2 – Subjektet që kanë paraqitur padi gjatë këtyre zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023

Përgjatë analizës së kryer, subjektet që zënë numrin dhe përqindjen më të lartë të paraqitjes së padive të pasqyruar në grafikun nr. 2 janë Partitë Politike në 12 vendime, të ndjekura nga padi të paraqitura nga individët, në 9 vendime, 4 raste të paraqitura nga Koalicioni, 2 raste të padive të paraqitura nga individë dhe koalicion së bashku dhe në një rast është paraqitur nga 1 bashki.



Grafiku nr. 3 – Pranimi/ rrëzimi i padive të zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023

Janë marrë në shqyrtim gjithashtu edhe numri i padive të pranuar, të rrëzuara, të pranuar pjesërisht apo të pushuara, të pasqyruar në grafikun e 3-të. Nga analiza vihet re që janë 16 raste për të cilat Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë, të cilat zënë 57% të rasteve të analizuara, e

ndjekur kjo me pushimin e gjykimit për 7 padi (25% të rasteve), pranim e padisë për 2 çështje (7% të rasteve të marra në shqyrtim) dhe pranim i pjesshëm i padisë për 3 prej tyre (11%).

III. VENDIMET E KOLEGJIT ZGJEDHOR GJYQËSOR TË ANALIZUARA NË SHTRIRJE KOHORE

Lëvizja e Re (LRE) kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendim Nr.1, Dt. 23.02.2022

Subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, nuk depozitoi në KQZ vërtetimin për zotërimin e mandatit përfaqësues ose depozitimimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve të kandidatit të saj për kryetar bashkie

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Bashkinë Durrës caktuar më datë 06.03.2022 me anë të dekretit të Presidentit nr. 13438, datë 20.01.2022,.

Në rastin konkret, subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” i është refuzuar kërkesa për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës. Subjekti zgjedhor ka kundërshtuar vendimin nr. 08, datë 15.02.2022, “Për Shqyrtimin e Kërkesës Ankimore Nr. 03, të paraqitur në KQZ në datë 12.02.2022” të KAS, duke paraqitur padi pranë KZGJ në datë 17.02.2022.

Kolegji vlerësoi se palës paditëse i takon të drejta ligjore për të kërkuar nga Kolegji shqyrtimin e pretendimeve të saj.

*** Koment**

Nëpërmjet vendimmarrjes së këtij rasti, Kolegji ka konfirmuar mënyrën e mbështetjes së kandidatëve për organet e njësisive të qeverisjes vendore të paraqitura nga partitë politike të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në kuvend, ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore. Kolegji ka theksuar çfarë nënkupton mandati në këshillin bashkiak, duke bërë diferencën ndërmjet mbështetjes personale nga ajo politike që i duhet kandidatit për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore. Kolegji vlerëson se KAS nuk mund të dispononte për regjistrimin e kandidatit pa përmbushur, të paktën, njërin nga kushtet e parashikuara në nenin 68 pag.2 të Kodit Zgjedhor. Kushtet e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor për regjistrimin e kandidatit, duhet të plotësohen domosdoshmërisht, pasi ndikojnë në mos regjistrimin e kandidatëve.

Partia Lëvizja e Legalitetit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendim nr. 1, Dt. 09.03.2023

Partia Lëvizja e Legalitetit, si parti politike nuk mund të anashkalonte detyrimet për raportimin financiar sipas Kodit Zgjedhor, duke mos i përmbushur ato, thjesht me justifikimin se ishte detyrim i partisë udhëheqëse të koalicionit.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me dhënien nga ana e KAS të masës administrative për partinë politike “Partia Lëvizja e Legalitetit”, gjobë në shumën 500,000 lekë, duke qenë se kjo parti për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021 nuk kishte dorëzuar raportet financiare për tre kandidatë të listave shumë emërore dhe për këtë arsye nuk janë audituar raportet e kandidatëve.

Në padinë e shqyrtuar nga Kolegji, paditësi pretendon se në zgjedhjet parlamentare, Partia Lëvizja e Legalitetit ka qenë subjekt në koalicionin PD-AN, ku në bazë të Kodit Zgjedhor neni 65/3 përcakton se çdo detyrim ligjor pranë KQZ në zbatim të Kodit Zgjedhor përmbushet nga partia udhëheqëse e këtij koalicioni (PD).

Në këtë rast kundërshtohet vendimi i KAS nr. 07, datë 25.01.2023, dhe kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 24.02.2023.

Kolegji vlerësoi se paditësit i takon e drejta ligjore për të kërkuar nga Kolegji shqyrtimin e pretendimeve të tij. Kolegji vendosi rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në prova dhe në ligj.

*** Koment**

Subjektet zgjedhore kanë liri në garën politike për të konkurruar në format e parashikuara nga Kodi Zgjedhor duke përfshirë edhe koalicionet zgjedhore. Me qëllim që të rritet transparenca e partive politike dhe ndërgjegjësimi i tyre në momentin që përfshihen në koalicion zgjedhor, sugjerojmë parashikimin në Kodin Zgjedhor të elementëve më të domosdoshëm që duhet të ketë marrëveshja e koalicionit, me qëllim që ato të jenë gjithëpërfshirëse dhe në harmoni me paragrafin 3, të nenit 65 të Kodit Zgjedhor.

Neni 65 Kodi Zgjedhor

3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.

Paqartësi në Kodin Zgjedhor

Përgjatë analizës së këtij vendimi u konstatua pasaktësi në Kodin Zgjedhor lidhur me përjashtimin që u lind subjekteve zgjedhore për të bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mos marrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Neni 145, pika 2 e Kodit i referohet shkronjave “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të Kodit, shkronja të cilat nuk janë pjesë e këtij neni.

Partia Bindja Demokratike kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 2, Dt. 09.03.2023

Pushimin e gjykimit të kërkesëpadisë së ngritur nga Bindja Demokratike pasi çështja është në kompetencë lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi kompetenca lëndore e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet që lindin nga procesi zgjedhor

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e partisë politike “Bindja Demokratike” për anulimin e vendimit të KAS nr. 07, datë 25.01.2023, nëpërmjet të cilit është vendosur sanksioni administrativ për shkelje në lidhje me raportimin financiar ndaj këtij subjekti zgjedhor në masën 500,000 lekë, sipas nenit 173, pika 3, të Kodit Zgjedhor.

Kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 24.02.2023.

Kolegji vendosi pushimin e gjykimit të çështjes nr. 2 regj. Them., datë 24.02.2023 dhe dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*** Koment**

Në rastin e dy vendimeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, vendimit nr. 1 datë 09.03.2023 dhe vendimit nr. 2, datë 09.03.2023 janë konstatuar që kemi zgjidhje të ndryshme për çështje me objekt të njëjtë ose të përafërt. Të dyja çështjet kanë objekt ankimin e vendimit të KAS në lidhje me vendosjen e masës administrative gjobë, në shumën 500.000 lekë për mosdorëzim të raporteve financiare. Në rastin e parë KZGJ ka dalë në vendimmarrje duke lënë në fuqi vendimin e KAS për vënien e masës administrative ndaj subjektit zgjedhor, ndërsa në rastin e dytë KZGJ ka pushuar çështjen dhe e ka dërguar atë për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Kjo mënyrë vendimmarrje nga ana e KZGJ nuk i shërben qëndrueshmërisë së jurisprudencës në zgjidhjen e çështjeve me objekt të ngjashëm, duke bërë të mundur që ligji të lexohet dhe të zbatohet në mënyra të ndryshme.

Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar kundër Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr. 3, Dt. 09.03.2023

Partia LZHK nuk ka plotësuar detyrimet ligjore për paraqitjen e të dhënave financiare dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e partisë politike “Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar” për ndryshimin e Vendimit të KAS nr. 07, datë 25.01.2023, me anë të të cilit është vendosur sanksioni administrativ për shkelje në lidhje me raportimin financiar ndaj subjektit zgjedhor “Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar” gjobë në masën 500,000 lekë, sipas nenit 173, pika 3, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”, i ndryshuar”, gjobë në masën 100 000 Lekë si masë administrative për financierin e partisë, si dhe detyrim i partisë politike “Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar” të kthejë në KQZ shumën prej 55.166,74 lekë.

Kolegji vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Zgjidhja e këtij rasti lidhet sërish me rastin e dy vendimeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, vendimit nr. 1 datë 09.03.2023 dhe vendimit nr. 2, datë 09.03.2023 për të cilët është konstatuar që gjykata ka dhënë zgjidhje të ndryshme për çështje me objekt të njëjtë ose të përafërt. Të tri çështjet kanë objekt ankimin e vendimit të KAS në lidhje me vendosjen e masës administrative gjobë, për mosdorëzim të raporteve financiare. Si në vendimin nr. 1, datë 09.03.2023 ashtu edhe në rastin aktual, KZGJ ka dalë në vendimmarrje duke lënë në fuqi vendimin e KAS për vënien e masës administrative ndaj subjektit zgjedhor, ndërsa në rastin e vendimit nr. 2, datë 09.03.2023 KZGJ ka pushuar çështjen dhe e ka dërguar atë për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Ashtu sikurse e kemi theksuar në vendimmarrjet e analizuara më herët, standarti i ndryshëm në vendimmarrje nuk i shërbejnë qëndrueshmërisë së praktikës gjyqësore, dhe mbartin premisa për të cenuar parimin e besimit të publikut tek organet e drejtësisë.. **Partia “Lëvizja BASHKË” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Vendim nr. 4, Dt. 21.03.2023

Partia “Lëvizja Bashkë” i ka marrë të gjithë masat e duhura për plotësimin e dy kushteve kumulative, konkretisht miratimin e partisë politike dhe regjistrimin brenda afateve të përcaktuara në ligj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e partisë politike “Lëvizja BASHKË” për rrëzimin e vendimit nr. 157 datë 09.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; për rrëzimin e vendimit nr.23 datë 14.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, dhe detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimin e Partisë Politike “Lëvizja BASHKË” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve për qeverisjen vendore të datës 14 maj 2023.

Subjekti zgjedhor “Lëvizja BASHKË” është parti politike regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2 datë 02.03.2023, marrë formë të prerë më datë 20.03.2023. Kolegji vendosi pranimin e padisë duke çmuar se padia e paraqitur nga Partia ‘Lëvizja BASHKË’ është e mbështetur në prova dhe në ligj.

*** Koment**

Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit Zgjedhor, pas regjistrimit të subjekteve zgjedhore, kryhet regjistrimi i koalicioneve dhe më pas paraqiten listat e kandidimit. Kundrejt afateve që përcakton Kodi Zgjedhor, lidhur me këto hapa përgatitore për procesin, nuk caktohet ndonjë afat i prerë për KQZ-në, lidhur me marrjen e vendimit për regjistrimin e subjektit zgjedhor, koalicionit, apo listat e kandidimit.

Referuar dispozitave të Pjesës IV të Kodit Zgjedhor dhe posaçërisht nenit 67 të Kodit Zgjedhor, afati për depozitimin e listave të kandidatëve është deri 50 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Në këto kushte, kur kërkesa e palës paditëse është depozituar në afatin e përcaktuar në ligj, do të sugjerohet që Komisioneri mund të merrte një vendim të ndërmjetëm për pezullimin e procedurës së nisur, deri në përfundim të afatit të ankimit ndaj vendimit gjyqësor për regjistrimin e partisë politike kërkuese (afati i ankimit përfundonte në datë 17.03.2023), në përputhje me nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative.

Nisur nga ky rast, është e nevojshme që të reflektohet vendimi i ndërmjetëm si mekanizëm vendimmarrje në momente të përcaktuara qartësisht në Kodin Zgjedhor për t’u dhënë të drejtën subjekteve për një vendim të drejtë, në raport me kërkesën për regjistrim si subjekt zgjedhor dhe jo vetëm.

Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr. 5, Dt. 27.03.2023

Rrëzim i padisë për sa kohë që kërkimin për ç’regjistrimin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e përfaqësuar nga nënkryetari z. Enklejd Alibeaj, pala paditëse nuk legjitimohet t’a paraqesë para Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, sa kohë që vetë nuk është subjekt zgjedhor, që më tej t’i cenohen interesat nga vendimmarrja e KAS

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse “Partia Demokratike e Shqipërisë” me kryetar z. Sali Berisha ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me person të interesuar Partinë Demokratike për të detyruar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të çregjistrojë subjektin “Partia Demokratike” e regjistruar me nënkryetarin, z. Enklejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar; të regjistrojë Partinë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si dhe të rregullojë pasojat duke detyruar Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve të

përfshijë subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha si pjesë e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, koalicion i regjistruar nga KSHZ me vendimin e tij të datës 18.03.2023.

KZGJ ka konkluduar se pala paditëse Partia Demokratike, me kryetar z. Sali Berisha, për sa kohë që nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor, nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimmarrjen e KAS në lidhje me regjistrimin e një subjekti tjetër zgjedhor në kuptim të nenit 145 të Kodit Zgjedhor. Ky parashikim ligjor përcakton se vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor. Si rrjedhojë, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Në rastin konkret, një nga momentet më të diskutueshme të çështjes lidhet me individin që ka të drejtë të paraqesë kërkesën për regjistrimin e një partie si subjekt zgjedhor. Në nenin 64 të Kodit Zgjedhor parashikohet që çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ, jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve, të shoqëruar me dokumentacion respektiv të përcaktuar në germën “b” të këtij neni. Neni nuk parashikon qartësisht se cili është organi kompetent i cili duhet të paraqesë kërkesën. Nga ana tjetër Kodi Civil në dispozitat mbi përfaqësimin e parashikon si mundësi ligjore të drejtën e përfaqësimit nëpërmjet autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndryshme juridike. Lidhur me sa më sipër, rekomandohet që të saktësohet organi përkatës në lidhje me paraqitjen e kërkesës për regjistrim të një partie politike si subjekt zgjedhor pranë KQZ, sikundër edhe e drejta e përfaqësimit nga organe të tjera në mungesë të kryetarit të partisë.

Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr.6, Dt. 30.03.2023

Pretendimi i paditësit se, në vendimin e tij Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të kishte vendosur që emri i Partisë Demokratike të Shqipërisë të ishte hequr nga aktmarrëveshja pasi cenonte interesat e paditësit në këtë gjykim, përbënte një pretendim të pabazuar në ligj.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” me kryetar të komanduar/nënkryetar të saj z. E. Alibeaj ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me person të interesuar koalicionin “BASHKË FITOJMË” për shfuqizimin e vendimit nr. 32, datë 23.03.2023 të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 37, datë 21.03.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, për shfuqizimin e vendimit nr. 178, datë 18.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, (BF) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, si dhe për plotësimin e të metave nga ana e kërkuarit Partia e Lirisë duke ndryshuar marrëveshjen e koalicionit duke hequr Partinë Demokratike të Shqipërisë nga referimi në këtë dokument.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi të rrëzojë padinë.

*** Koment**

Në rastin konkret, një nga momentet më të diskutueshme të çështjes lidhet me marrëveshjen e koalicionit të bërë mes subjekteve politike dhe të depozituar në KQZ. Një nga momentet të cilat nuk janë të trajtuara gjerësisht në Kodin Zgjedhor lidhet me marrëveshjet e koalicionit. Kodi Zgjedhor nuk ka parashikime të veçanta për marrëveshjet që realizohen midis partive politike që janë pjesë e një koalicioni, por në nenin 65 pika 3 të tij, parashikon në mënyrë të përgjithshme dhe deklarative këtë marrëveshje.

Neni 65

1. *Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.*

Duke u nisur nga mosmarrëveshjet zgjedhore që kanë qenë objekt shqyrtimi i organeve të administrimit zgjedhor dhe Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, KShH vlerëson se Kodi Zgjedhor duhet të parashikojë në mënyrë të qartë elementët e domosdoshëm të marrëveshjes së koalicionit (objektin, të drejtat dhe detyrimet e palëve) si dhe kompetencën e KQZ në shqyrtimin dhe pranimin e marrëveshjes.

Lodovik Hasan kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr. 7, Dt. 05.04.2023

Gjobjtja nga KAS, e paditësit, pa u njoftuar, thirrur dhe dëgjuar në lidhje me shkeljen për të cilën është gjetur përgjegjës. Një proces i tillë administrativ ka cenuar parimin e ligjshmërisë, pasi nuk mund të vendoset një gjohë administrative pa u respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, kandidatit Ludovik Hasan (të subjektit Partia Republikane) ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve” për shfuqizimin e pikës 3 të vendimit nr. 7, datë 25.01.2023 të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve “ që ka të bëjë me vendosjen e sanksionit administrativ kundër paditësit, në masën 500,000 lekë”, për mosdorëzimin e raporteve të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Subjekti, Ludovik Hasan ka qenë i legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në kuptim të nenit 2/20 të Kodit Zgjedhor “**subjekt zgjedhor konsiderohen partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod**”.

Referuar këtij rregullimi kandidati i subjektit zgjedhor kur KAS e ngarkon me përgjegjësi administrative, ka të drejtë të në kuadër të auditimit financiar të fondeve që përfitohen dhe shpenzohen gjatë një fushate zgjedhore, në vend të subjektit zgjedhor që të paraqesë ankimin para Kolegjit kundër vendimmarrje përkatëse të KAS,. Kjo pasi subjekti zgjedhor për të cilin paditësi ka qenë kandidat, nuk i mbron dhe përfaqëson interesat e tij, pasi ka pretenduar se shkelja është kryer nga kandidati dhe jo nga subjekti zgjedhor,.

Ankimi në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor është paraqitur pas dy muajsh nga shpallja e vendimit të KQZ, në shkelje me nenin 152, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

Nisur nga analiza e fakteve, pala paditëse në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë ka ngritur pretendime për shkelje të të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe Kodin Zgjedhor, përse i përket procesit të rregull ligjor.

Kolegji thekson se në gjykim rezultoi se KAS ka zhvilluar seancën dëgjimore në prani të përfaqësuesit të subjektit zgjedhor Partia Republikane, pasi kërkesa e Komisionerit ka qenë për gjobitjen e këtij subjekti zgjedhor për shkak të mosdorëzimit të raportit të të ardhurave dhe shpenzimeve për kandidatin e këtij subjekti.

Kolegji konstaton se paditësi është gjobitur nga KAS, pa u njoftuar, thirrur dhe dëgjuar në lidhje me shkeljen për të cilën është gjetur përgjegjës. Një proces i tillë administrativ ka cenuar parimin e ligjshmërisë, pasi nuk mund të vendoset një gjobë administrative pa u respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor. KAS kishte detyrimin të respektonte parashikimin e nenit 4 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative ku thuhet se “*të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.*” Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pranimin e padisë të paraqitur nga subjekti z. Ludovik Hasan.

*** Koment**

Në rastin e katër vendimeve të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, vendimit nr. 1 datë 09.03.2023, vendimit nr. 2, datë 09.03.2023, vendimi nr. 3, datë 09.03.2023 dhe vendimi nr. 7, datë 05.04.2023 janë konstatuar që kemi zgjidhje të ndryshme për çështje me objekt të njëjtë ose të përafërt. Çështjet për tre rastet e para kanë objekt ankimin e vendimit të KAS në lidhje me vendosjen e masës administrative gjobë, në shumën 500.000 lekë për mosdorëzim të raporteve financiare. Në rastin e parë dhe të tretë KZGJ ka dalë në vendimmarrje duke lënë në fuqi vendimin e KAS për vënien e masës administrative ndaj subjektit zgjedhor, ndërsa në rastin e dytë KZGJ ka pushuar çështjen dhe e ka dërguar atë për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Edhe rastin e katërt e ka trajtuar po KZGJ por ka pranuar padinë e ngritur nga subjekti kandidat për deputet, duke shfuqizuar pikën 3 të vendimit nr. 7, datë 25.01.2023 të KAS.

Për më shumë në rastin e katërt, është cenuar parimi i procesit të rregullt ligjor nga ana e KQZ, duke marrë vendimin pa dijeninë e subjektit të cilit i referohej kundërvajtja administrative me masë gjobë, pa njoftuar subjektin dhe pa prezencës e tij. Kjo e bën palën paditëse jo palë pjesëmarrëse në procesin e hetimit administrativ nga ana e KQZ, për rrjedhojë edhe afati i paraqitjes së padisë në KZGJ nuk lidhet me shpalljen e vendimit të KAS. Parimi i "njoftimit dhe mundësisë për t'u dëgjuar" është thelbësor për të garantuar drejtësi dhe proces të rregullt në procedurat administrative. Ky parim kërkon që individët ose palët e prekura nga veprimet administrative të informohen për veprimet që po ndërmerren ndaj tyre dhe t'u jepet mundësia të paraqesin çështjen e tyre ose të përgjigjen përpara se të merret një vendim.

Mehmet Nelaj kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr. 8, Dt. 11.04.2023

Detyrimi për krijimin dhe regjistrimin e komitetit nismëtar u gjet nga organet e KQZ-së, si e metë thelbësore, që pas solli refuzimin për regjistrim të kandidatit

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse z. Mehmet Nelaj për kundërshtimin e vendimit nr. 38, datë 31.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve, ndryshimin e tij duke pranuar kërkesën për regjistrimin e paditësit Mehmet Nelaj si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Palës paditëse i është refuzuar kërkesa për regjistrimin si kandidat i pavarur, për shkak të mungesës së komitetit nismëtar, fillimisht me anë të vendimit të KZAZ nr. 90 e Bashkisë Sarandë dhe më pas vendimit të sipërpërmendur të KAS.

Pala paditëse z. Nelaj ka qenë i legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Gjatë hetimit gjyqësor në Kolegjin Zgjedhor kanë dalë prova të reja të cilat nuk kanë qenë prezent gjatë gjykimit të çështjes në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (pranë KAS), duke depozituar konkretisht Formularin Model KQZ-04-05. “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit”. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi të rrëzojë padinë e ngritur nga z. Nelaj për t’u regjistruar si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023 për shkak të mungesës së komitetit nismëtar.

*** Koment**

Procedura që duhet të ndiqet për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit parashikohet nga neni 70 i Kodit Zgjedhor. Në pikën 3 të nenit 70 parashikohet detyrimi për krijimin e një komiteti nismëtar, në rast se kandidati propozohet nga zgjedhësit. Pika 4 e këtij neni ka parashikuar si përjashtim detyrimin që buron nga pika 3, në rast se kandidatët e propozuar nga zgjedhësit janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit. Pika 4 e nenit 70 nuk përcakton përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të nenit 70, i cili në rastin e z. Nelaj do të kuptohet që nuk është e nevojshme të krijohet një komitet nismëtar për marrjen e firmave mbështetëse. Vlen të theksohet se z. Nelaj është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019, po në bazë të të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 70 të Kodit Zgjedhor. Interpretimi i bërë i këtij neni nëpërmjet Udhëzimit nr. 1, datë 18.01.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve cenon parimin e sigurisë juridike duke mos mbrojtur të drejtat e fituara dhe pritshmëritë e ligjshme të subjekteve të të drejtës.

Partia “Nisma Thurje” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr. 9, Dt. 13.04.2023

Kandidati ka plotësuar dokumentacionin brenda afatit ligjor dhe për rrjedhojë, ai duhet të regjistrohet në zgjedhjet vendore pasi nuk rezulton të jetë pasqyruar ndonjë shënim, sa i takon mungesës së dokumenteve të identifikimit dhe se nuk përmbushen kushtet ligjore për refuzimin e regjistrimit si dhe penalizimi për mosveprimin e tij, nuk mund të ketë efekt në rastet e mungesës së dijenisë.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse Partia “Nisma Thurje” dhe z. Kosta Garo për ndryshimin e Vendimit nr. 10 datë 28.03.2023 të KZAZ-së nr. 82 dhe Vendimit nr. 43 datë 03.04.2023 të KAS, lidhur me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Në rastin konkret, palës paditëse i është refuzuar kërkesa për regjistrimin e z. Kosta Garo si kandidat i pavarur, për shkak të mungesës së dokumentacionit të rregullt.

Pala paditëse Partia “Nisma Thurje” dhe z. Kosta Garo kanë qenë të legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Nisur nga analiza e fakteve, pala paditëse në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë ka ngritur pretendime për shkelje të të drejtave që lidhen me procesin e rregullt ligjor, pasi vlerësimi i dokumenteve të dorëzuara, vendimmarrja e organeve administrative dhe njoftimi kundrejt palës paditëse janë kryer në mungesë të transparencës përgjatë procesit duke mos e njoftuar palën paditëse. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pranimin e padisë.

*** Koment**

Nisur nga analiza e çështjes konstatohet që organet e administratës zgjedhore, konkretisht KZAZ nr. 82 dhe Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në KQZ kanë vepruar në shkelje të procedurave ligjore dhe duke cenuar një sërë parimesh të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në Kodin e Procedurës Administrative³⁹. Në bazë të nenit 3, pika 6 e Kodit Zgjedhor, komisionet zgjedhore i përmbushin funksionet e tyre, në përputhje me ligjin, në mënyrë të paanshme dhe transparente. Parimi i transparencës sanksionohet gjithashtu edhe në Kodin e Procedurave Administrative. Neni 5 i këtij kodi parashikon detyrimin e organeve publike për të ushtruar veprimtari administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të. Për më shumë neni 10 i Kodit të Procedurave⁴⁰ Administrative sanksionon parimin e dhënies së ndihmës aktive, parim i cili është shkelur nga ana e organeve të administratës zgjedhore.

Eduard Nallbani kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr.10, Dt. 18.04.2023

Komiteti nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore nuk kishte arritur të mblidhte firmat mbështetëse për kandidatën që i korrespondon kufirit minimal prej 1% të listës së zonës zgjedhore Bashkia Tiranë (të paktën 7,000 firma)

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse z. Eduard Nallbani për rrëzimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 220 datë 30.03.2023, rrëzimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve nr. 44, datë 04.04.2023, për detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendim për regjistrimin e z. Eduard Muhamet Nallbani si kandidat për anëtar të këshillit bashkiak i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”. Në rastin konkret, refuzimi për tu regjistruar është argumentuar me mungesën e kufirit minimal të numrit të zgjedhësve prej 1% (7000 zgjedhës) të listës së zonës zgjedhore Bashkia Tiranë.

³⁹ Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

⁴⁰ Neni 10

Parimi i dhënies së ndihmës aktive

1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.

Pala paditëse z. Eduard Nallbani ka qenë i legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Kolegji vlerësoi se padia e z. Eduard Nallbani duhet të rrëzohet si e pa mbështetur në prova dhe në ligj.

*** Koment**

Interpretimi i kryer nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor është i mbështetur dhe në përputhje me nenin 70 të Kodit Zgjedhor, i cilit parashikon rregullat që duhet të ndiqen nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore. Mbështetja e kandidaturës nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 % të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, ekziston si rregull jo vetëm për kandidatët për kryetar të bashkisë, por ky detyrim ekziston edhe në rastin e kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish për anëtar të këshillit vendor (bashkiak).

Partia Aleanca Progresiste (LZHK) e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr.11, Dt. 18.04.2023

Rrëzim i padisë pasi subjekti zgjedhor ka qenë në dijeni të parregullsisë në dokumentacion dhe po kështu ka mundur që të plotësojë parregullsitë, duke i dorëzuar dokumentacionin brenda afatit të kërkuar.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse Partia Aleanca Progresiste LZHK për anulimin e Vendimit të KAS datë 05.04.2023 me anë të të cilit, palës paditëse i është refuzuar kërkesa për të regjistruar listës shumë emërore për kandidatët për këshillin bashkiak në bashkinë Përrenjas, për arsye se dokumentacioni ishte i parregullt.

Kolegji vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

*** Koment**

Interpretimi i Kolegjit është i mbështetur dhe në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, ku në nenin 73 përcaktohet se: “1. *KQZ-ja ose, sipas rastit, KZAZ-ja verifikon rregullsinë e dokumentacionit të kandidimit dhe nëse vëren parregullsi apo mos përmbushje të kërkesave të këtij Kodi, ia kthen ato subjekteve zgjedhore për korrigjim jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve. 2. Dokumentacioni i korrigjuar depozitohet jo më vonë se 42 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Vendimi për miratimin ose refuzimin e dokumentacionit përfundimtar merret brenda 48 orëve nga depozitimi i tyre...*”.

Partia e Unitetit Kombëtar kundër KAS

Vendimi Nr. 12, Dt. 18.04.2023

Rrëzim i padisë, pasi mos regjistrimi i subjektit Vebi Tahir Hana si kandidat për Kryetar të Bashkisë Përrenjas të paraqitur nga subjekti zgjedhor nga Partia e Unitetit Kombëtar, për mosplotësimin e dokumentacionit.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e subjektit zgjedhor Partia e Unitetit Kombëtar (PUK), për kundërshtimin e vendimit nr. 49, datë 06.04.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve dhe ndryshimin e këtij vendimi duke regjistruar z. Vebi Tahir Hana, si Kandidat për Kryetar të Bashkisë Përrenjas, i propozuar nga ky subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Refuzimi nga KAS është justifikuar me parregullsinë e dokumentacionit.

Kolegji vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Interpretimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është i mbështetur dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor, pjesa X e të cilit parashikon ankimin në rrugë administrative dhe afatin përkatës. Neni 124 titulluar “E drejta e ankimit”⁴¹ parashikohen se: “1. Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, **brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit**. Gjithashtu Kolegji është mbështetur edhe në nenin 130/ c të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se: “KQZ-ja merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon elementet e mëposhtme: a)...c) **respektimin e afateve ligjore për ankimin**.”

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër KQZ

Vendimi Nr. 13, Dt. 21.04.2023

Komponentët e detyrueshëm që përmban fleta e votimit janë të zbatueshëm për të gjitha subjektet zgjedhore, përfshi këtu edhe koalicionet zgjedhore, për rrjedhojë padia rrëzohet si e pabazuar.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e koalicionit ‘Bashkë Fitojmë’, përfaqësuar nga Partia Udhëheqëse e Koalicionit “Partia e Lirisë” dhe person i interesuar “Partia Demokratike e Shqipërisë” për ndryshimin e Vendimit nr. 61, datë 19.04.2023 të KAS duke vendosur: “Ndryshimin e vendimeve nr. 361 dhe 362 të KSHZ, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, si dhe për 60 bashkitë e tjera në vend, duke vendosur përbri emrit të Koalicionit “Bashkë Fitojmë” emrin e z. Sali Berisha.”.

Në rastin konkret, pretendimet e palës paditëse dhe të personit të interesuar lidhen me përmbajtjen e fletës së votimit.

Kolegji vendosi të rrëzojë padinë.

*** Koment**

Në këtë rast Kolegji ka interpretuar nenin 98 të Kodit Zgjedhor që përmban elementët e fletës së votimit si dispozitën kryesore që përcakton përmbajtjen e fletës së votimit për të gjitha subjektet zgjedhore duke përfshirë këtu edhe koalicionet. Duke qenë se neni 98, pika 3, fjalia e parë e Kodit Zgjedhor parashikon elementë të përmbajtjes së fletës së votimit lidhur me subjektet zgjedhore, në vijim, në fjalinë e dytë specifikimi për sa i përket përmbajtjes së fletës së votimit lidhet vetëm me partinë duke mos përmendur në mënyrë specifike koalicionet. Është e nevojshme që komponentët në lidhje me identifikimin e subjekteve zgjedhore, të jenë të detyrueshëm jo vetëm për partitë politike por edhe për koalicionet si subjekte zgjedhore, duke u përcaktuar qartësisht në Kodin Zgjedhor. Nga ana tjetër, KShH rekomandon një disiplinim më i mirë i Kodit Zgjedhor për sa i përket regjistrimit të koalicionit, raportit juridik të tij në kuadër të procesit zgjedhor, të drejtat dhe detyrimet e palëve si dhe të partisë udhëheqëse, me qëllim identifikimin e qartë të subjekteve zgjedhore dhe transparencën si ndërmjet partive politike që janë pjesë e koalicionit por edhe përballë votuesve.

⁴¹ Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.07.2012

Koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’ kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 14, Dt. 21.04.2023

Mrëzim i padisë me arsyetimin se vendimi për të pasqyruar në fletën e votimit për kandidatët për kryetar bashkie edhe të logos së subjektit zgjedhor që i ka propozuar ata, nuk përbën cenim të interesave të ligjshme të subjektit zgjedhor ankues dhe as të procesit zgjedhor në tërësi

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, koalicioni ‘BASHKË FITOJMË’ dhe person i interesuar “Partia Demokratike e Shqipërisë” për ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 19.04.2023 të KAS, duke vendosur: *Ndryshimin e vendimeve nr. 360 dhe nr. 363 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 15.04.2023, duke ndryshuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar të Bashkisë Tiranë, si dhe për 60 bashkitë e tjera në vend dhe heqjen e logos së partive dhe/ose të koalicioneve, nga përmbajtja e fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023*”.

Subjekti zgjedhor koalicioni ‘BASHKË FITOJMË’ ka qenë e legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në rastin konkret, pretendimet e palës paditëse dhe të personit të interesuar lidhen me përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie (në ndryshim nga vendimi i mësipërm ku bëhet fjalë për fletët e votimit për Këshillin Bashkiak).

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Në këtë rast Kolegji i është përmbajtur interpretimit që i ka bërë në vendimin e mësipërm Kodit Zgjedhor duke vlerësuar nenin 98 që përmban elementët e fletës së votimit si dispozitën kryesore që përcakton përmbajtjen e fletës së votimit për të gjitha subjektet zgjedhore, duke përfshirë këtu edhe koalicionet. Nga ana tjetër, nisur nga vendimi nr. 13 dhe nr. 14 datë 21.04.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor objekti i të cilave lidhet me përmbajtjen e fletës së votimit, rekomandohet një disiplinim më i mirë i Kodit Zgjedhor për sa i përket nenit 98 / 3 në lidhje me përmbajtjen e fletëve të votimit. Duke qenë se fjalia e parë e pikës 3 i drejtohet të gjitha subjekteve zgjedhore, përmendja e fjalës “partit” dhe jo subjekt zgjedhor në fjalinë e dytë, të krijon përshtypjen e një përdorimi më të kufizuar se ku do të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë.

- 2. Emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi.*

Për këtë qëllim është e nevojshme të mbahet një terminologji juridike e gjuhësore e njëjtë për subjekte apo objekte të njëjta, me qëllim shmangien e paqartësisë në dispozitat ligjore.

Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendim Nr.15, Dt. 24.04.2023

Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë, për rrjedhojë në rastin konkret kemi pushim të gjykimit.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe person i interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shfuqizimin e Vendimit Nr. 53, dt.10.04.2023 të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore Nr.48, Dt.07.04.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe ndalimin e kandidimit të Kandidatit për Kryetar Bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Pala paditëse, subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur pretendimin që është e legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Sipas saj, të drejtën e ankimit pranë Kolegjit kanë subjektet zgjedhore, të cilëve u janë cenuar interesat e tyre të ligjshme, brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa sipas KAS, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike” nuk është në kushtet e pikës 1 të nenit 33 të KPrA, sepse ai nuk është subjekt që ka kërkuar fillimin e procedurës administrative, sikurse nuk është subjekt ndaj të cilit të ketë filluar procedura, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi nr. 300, datë 05.04.2023. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pushimin e gjykimit të çështjes administrative.

*** Koment**

Kushtetuta e RSH ka parashikuar në nenin 45 të saj kufizimet e të drejtës për t’u zgjedhur ku thuhet se: *“3. Përjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.”*

Kodi Zgjedhor, në nenin 63, pika 3 të tij i është referuar dispozitës kushtetuese në lidhje me kushtet për tu zgjedhur të kandidatëve.

Neni 63

Subjektet zgjedhore dhe kandidatët (Ndryshuar me ligjin nr. 74/2012, datë 19.7.2012)

3. Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 45, pika 3 të Kushtetutës, është miratuar nga Kuvendi i RSH ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” i cili ka si qëllim që të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura, siç parashikon shprehimisht në nenin 1 të tij. Ligji vendos kufizime në lidhje me shtetasit që dëshirojnë të kandidojnë në zgjedhjet vendore dhe qendrore, kur ata kryejnë vepra penale. Konkretisht, ligji nr. 138/2015, parashikon ndër të tjera në nenin 2, pika 1, germa “ç” se nuk mund të kandidojnë për kryetar bashkie personat, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me jo më pak se 6 muaj burgim për kryerjen e një krimi me dashje. Ndërkohë në nenin 4 të ligjit parashikohet koha e këtij ndalimi për këta persona për të ushtuar të drejtën për t’u zgjedhur, e cila në pikën 4 përcakton se për personat

që konsiderohen të dënuar sipas nenit 2/ 1, gërma “ç” e ligjit, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Nga ana tjetër në nenin 4/9 të ligjit nr. 138/2015 parashikohet sipas gërmës “a” se në masën e dënimit nuk do të përfshihet ndër të tjera ulja e dënimit për shkak të gjyqimit të shkurtuar apo pezullimi i dënimit me burgim, apo çdo shkurtrim i dënimit, si dhe b) këto shkurtime dënimi apo pezullime dënimi nuk ndikojnë në zbatimin e ligjit nr. 138.2015 dhe nuk llogariten në funksion të shkurtrimit të afatit të dënimit me qëllim shkurtrimin e periudhës së ndalimit të parashikuar në këtë ligj.

Neni 5 / 4 e ligjit nr. 138/2015 parashikon që formulari i vetëdeklarimit dorëzohet dhe administrohet, sipas rastit: a) pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të zgjedhurit dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë apo në organet e qeverisjes vendore. Komisioneri ka të drejtën të kryejë edhe *ex officio* verifikimin e përputhshmërisë së kandidatëve për kryetar bashkie me kërkesat e ligjit nr. 138/2015 dhe të nenit 45 të Kushtetutës, në bazë të nenit 33 shkronja “f” e Kodit Zgjedhor dhe nenit 5 të ligjit nr. 138/2015. Kjo pasi nëse një kandidat ka ndalim ligjor për t’u zgjedhur nuk duhet të lejohet të marrë pjesë në zgjedhje, pasi cenon vlefshmërinë e procesit zgjedhor.

Duke qenë se shtetasit që dëshirojnë të kandidojnë në zgjedhjet vendore dhe qendrore kryejnë funksione publike me rëndësi të veçantë për jetën politike dhe funksionimin e organeve të zgjedhura prej popullit, sugjerojmë si të nevojshme parashikimin në Kodin Zgjedhor të të drejtës që mund t’i lindë kujtdo që ka interes të drejtpërdrejtë vetjak apo në interes të publikut për të raportuar raste të kandidatëve kur ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar, në veçanti kur kanë deklaruar të kundërtën në formulari përkatës. Këto subjekte, duhet të legjitimohen të ushtrojnë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve përkatëse pranë KAS dhe Kolegjit Zgjedhor, në përputhje me fushën e kompetencës së tyre lëndore

Partia Demokratike e Shqipërisë kundër KQZ

Vendimi Nr.16, Dt. 24.04.2023

Rrëzim i padisë dhe mospranimit për shqyrtim të Kërkesës Ankimore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, për mungesë legjitimitimi substancial/material.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, subjekti zgjedhor ‘Partia Demokratike e Shqipërisë’ dhe person i interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shfuqizimin e Vendimit Nr.60, datë 19.04.2023 të KAS “Për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 49, datë 17.04.2023 të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”; shfuqizimin e vendimit nr. 366, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Shqyrtimin e kërkesës së partisë demokratike dhe verifikimin e të dhënave në formularin e vetë deklarimit të subjektit vetë deklarues z. Qerim Ismail Ismailaj, kandidat për kryetar të bashkisë Mallakastër i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” dhe ndalimin e kandidimit të Kandidatit për Kryetar Bashkie të Mallakastrës shtetasit Qerim Ismail Ismailaj të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Pala paditëse subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur pretendimin që është e legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Në bazë të kësaj dispozite të drejtën e ankimit pranë Kolegjin

Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, e kanë subjektet zgjedhore, të cilëve u janë cenuar interesat e tyre të ligjshme, brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor. Ndërsa sipas Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, subjekti zgjedhor "Partia Demokratike" nuk është në kushtet e pikës 1 të nenit 33 të KPrA⁴², sepse nuk është subjekt që ka kërkuar fillimin e procedurës administrative, sikurse nuk është subjekt ndaj të cilit të ketë filluar procedura, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi nr. 366, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor subjekti ankues legjitimohet formalisht, vetëm kur konfirmohet të ketë qenë pikërisht ai, iniciuesi i procedurës administrative; ose vetëm nëse ai, si subjekt që ka vënë në lëvizje procedurën administrative, provon se nëpërmjet vendimmarrjes respektive, i janë cenuar interesat në bazë të Nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

* **Koment**

Nisur nga analiza që i është bërë legjitimitetit të palës paditëse për të ngritur kërkesë padinë nga ana e gjykatës, është e nevojshme për të theksuar rëndësinë e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike në procesin zgjedhor, si dhe të drejtën e kujtdo për të raportuar një shkelje që lidhet me kriteret e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Është kriter kushtetues ndalimi i çdo individi për të ushtruar të drejtën kushtetuese për t'u zgjedhur për shkak të dënimit me burgim. Në bazë të këtij rregullimi kushtetues të parashikuar në nenin 45 të Kushtetutës është miratuar nga Kuvendi ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" që ka rregulluar në mënyrë më të detajuar këtë kufizim. Ky kriter është urdhëruar, në lidhje me ndalimin e të drejtën për t'u zgjedhur. Pra, kandidatët për kryetar bashkie që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 138/2015 nuk gëzojnë të drejtë për t'u zgjedhur dhe për pasojë kandidimi dhe përfshirja e tyre në zgjedhje do të ishte e paligjshme dhe antikushtetuese. Një shkelje e tillë, cenon rëndë procesin zgjedhor, që e bën atë të pavlefshëm sipas nenit 60 pika 1 gërma "a" e Kodit Zgjedhor që parashikon se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, në rast se: a) kanë ndodhur shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit, sipas kësaj shkronje, të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhor.

Nga ana tjetër, Kolegji në argumentimin e tij ka dalë në 2 konkluzione të rëndësishme: së pari që **autoriteti shtetëror i ngarkuar nga ligji, të bëje verifikimet përkatëse (në këtë rast Komisioneri), që të shterojë menjëherë, paraqitjen e kallëzimit penal pranë prokurorisë përkatëse; dhe së dyti: shtetasi Qerim Ismailaj, i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, pranë KZAZ nr.62 Mallakastër, duhet të ndalohet të kandidojë, për shkakun se sipas parashikimeve të ligjit 138/2015 "Për dekriminalizimin..." rezulton se bie brenda sferës së aplikimit të këtij ligji".**

⁴² Neni 33 Kodi i Procedurave Administrative
Pala në procedurën administrative

1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.

Megjithatë, këto konkluzione nuk i janë drejtuar organeve përkatëse me vendim gjykatë dhe kanë mbetur në nivelin e argumentit pa ngarkuar me përgjegjësi institucionet shtetërore, duke rezultuar në vendimmarrje nga ana e Kolegjit për rrëzimin e padisë.

Partia e Lirisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr.17 Dt. 09.05.2023

Padia nuk mund të shqyrtohet në thelb për shkak se, për të nuk është shprehur me një vendim të KAS, sipas kërkesës ankimore të paraqitur nga Partia e Lirisë

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, subjekti zgjedhor 'Partia e Lirisë' dhe person i tretë "Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet" për kundërshtimin e vendimit nr. 71, datë 02.05.2023 të KAS; ndryshimin e Vendimit nr. 71, datë 02.05.2023 të KAS në KQZ, duke vendosur: Caktimin e Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 ose në alternativë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr.71 dt.02.05.2023 të KAS për këto zgjedhje.

Kolegji vendosi pranimin pjesërisht të padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr.71 dt.02.05.2023 të KAS dhe detyrimin e KAS të marrë vendim brenda datës 10.05.2023, lidhur me Kërkesën Ankimore nr.53 dt.27.04.2023, depozituar nga subjekti zgjedhor "Partia e Lirisë".

*** Koment**

Interpretimi i kryer nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor është i mbështetur nga Kodi Zgjedhor, pjesa II, neni 21, pika 3 i cili parashikon kompetencat e KAS dhe detyrimin ligjor të pjesëmarrjes në vendimmarrje të anëtarëve të KAS. Në bazë të pikës 3 të nenit 21, si akte administrative bazë të KAS-it janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë, përveç vendimit që jepet sipas shkronjave "a", "b" ose "c" të pikës 1, kur objekt i ankimit është kundërshtimi i tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Në këtë rast vendimi merret kur pro tij votojnë së paku katër anëtarë. Për rrjedhojë një votim i marrë në kushte të tjera nga neni 21, pika 3 e bën të pavlefshme vendimmarrjen. Për sa më sipër interpretimi i bërë nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor është në përputhje me parimet dhe dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Partia e Lirisë Kundër Komisionit Qendror Të Zgjedhjeve

Vendimi Nr. 18, Dt. 12.05.2023

Rrëzim i padisë pasi pretendimet që lidhen me atë se çfarë do të ishte më e ndershme në mënyrën e kompozimit të GNV-ve, nuk përbëjnë çështje të zbatimit të ligjit por mbeten në kuadrin e sugjerimeve për ndryshime të ligjit zgjedhor, çka nuk hyn në kompetencën e gjykatës.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, subjekti zgjedhor 'Partia e Lirisë' dhe person i interesuar "Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet" për ndryshimin e Vendimit nr. 90, datë 10.05.2023 të KAS në KQZ, duke vendosur: Caktimin e Partisë së Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Në rastin konkret, pretendimet e palës paditëse lidhen me caktimin e Partinë e Lirisë si parti politike që i lind e drejta e propozimit për anëtarin e katërt të grupeve të numërimit të votave,

për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 në kundërshtim të vendimit të KSHZ i cili ka njohur si parti politike të opozitës parlamentare që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e katërt si Partinë e Lirisë ashtu edhe Partinë Drejtësi, Integrim, Unitet.

Kolegji vendosi rrëzimin e padisë.

* **Koment**

Interpretimi i kryer nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor është i mbështetur nga Kodi Zgjedhor, pjesa XIV Dispozita të fundit dhe kalimtare, neni 183, pika 8 i cili kushtëzon kompozimin e organeve të administratës zgjedhore dhe të drejtën e propozimit të këtyre anëtarëve në bazë të rezulttit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, i konstituar menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Kjo është një dispozitë kalimtare e miratuar nëpërmjet ndryshimeve që ju bënë Kodit Zgjedhor me anë të ligjit nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe që rregullon ngritjen e organeve zgjedhore vetëm për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin (ato të vitit 2021), si dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore (ato të vitit 2023).

Pavarësisht zgjidhjes së çështjes për të cilën është ngritur padi, në zgjidhje afatgjatë KSHH duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet ndër vite të OSBE/ODIHR-it rekomandon depolitizim të plotë të të gjitha organeve të administrimit zgjedhor, duke përfshirë edhe GNV-të ose në mënyrë alternative zbatimin në nivel kombëtar e jo të pjesshëm të procesit elektronik të numërimit të votave.

Bashkia Shijak kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 19 Dt.15.05.2023

Pushim i padisë, në kushtet që Bashkia Shijak nuk legjitimohet në ngritjen e padisë, pasi nuk ka interes të ligjshëm për paraqitjen e saj, por legjitimimi i takon personalisht Kryetarit të Bashkisë për të kundërshtuar vendimin Nr. 84 datë 08.05.2023 të KAS

* **Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Bashkia Shijak për shfuqizimin e vendimit nr. 84, datë 08.05.2023 të KAS pranë KQZ – së dhe revokimin e dënimit me gjobë për kryetarin e bashkisë z. Elton Arbana, në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Komisioni Qendror të Zgjedhjeve ka argumentuar që pala paditëse nuk ka legjitimitet për të paraqitur padinë në përputhje me nenin 145, pika 1 të Kodit Zgjedhor, pasi nëpërmjet vendimit nr. 84, datë 08.05.2023 "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të KSHZ", të KAS, nuk është vendosur sanksion administrativ ndaj Bashkisë Shijak, por ndaj subjektit zgjedhor, kandidatit për kryetar bashkie, z. Elton Arbana.

Kolegji Zgjedhor vendosi pushimin e gjykimit të çështjes, duke argumentuar se zbatimi i të së drejtës për një proces të rregullt ligjor tregohet në të drejtën që i është njohur palës të ngrejë padi për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e parashikuara në ligj gjë që përbën aspektin procedural formal duke e dalluar nga e drejta apo interesi material për mbrojtjen e të cilit shërben padia. Në rastin konkret nëpërmjet padisë së paraqitur nga Bashkia Shijak nuk evidentohet cenimi i një të drejte ose i një interesi që mund të pretendohet kundrejt palës tjetër.

* **Koment**

Interpretimi i kryer nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor është i mbështetur nga Kodi Zgjedhor, neni 2/20 dhe neni 145 të cilët parashikojnë cilët janë subjektet zgjedhore që gëzojnë të drejtën e ankimit në Kolegjin Zgjedhor⁴³. Në bazë të nenit 2/20 të Kodit Zgjedhor, “*subjekte zgjedhore*” janë partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruar në përputhje me këtë Kod”. Në rastin konkret, z. Elton Arbana është dënua administrativisht për shkak të veprimtarisë së tij si kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në cilësinë e tij si subjekt zgjedhor në kuptim të nenit 2 / 20 e Kodit Zgjedhor, cilësi të cilën e gëzon në mënyrë të pavarur nga funksioni i tij si Kryetar i Bashkisë Shijak. Ky i fundit legjitimohet personalisht të kundërshtojë vendimin e mësipërm të KAS, por nuk gëzon të njëjtin legjitimitet personi juridik publik, Bashkia Shijak, në të cilën z. Elton Arbana ushtron detyrën e Kryetarit të Bashkisë. Rrjedhimisht, vendimi i KZGJ-së është i bazuar dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Dallëndyshe Bici, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Vendimi Nr.20, Dt. 18.05.2023

Pushim i gjykimit pasi Kolegji vlerëson se nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie ku personi të tretë nuk është subjekt zgjedhor.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Dallëndyshe Bici, Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për shfuqizimin e Vendimit nr. (nuk është publikuar dhe njoftuar ende) datë 08.05.2023 të KAS vetëm përse i përket vendosjes së sanksionit administrativ, gjobë në masën 2,500 lekë, ndaj Znj. Dallëndyshe Bici, në lidhje me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pala paditëse, Dallëndyshe Bici ka pretenduar që ka qenë e legjitimuar për të paraqitur ankimin si pranë KAS-it ashtu edhe pranë KZGJ-së . Ndërsa, KZGJ ka argumentuar që pala paditëse nuk ka legjitimitet për të paraqitur padinë në përputhje me nenin 145, pika 1 të Kodit Zgjedhor, pasi ligjvënësi në parashikimet e kësaj dispozite, ka pasur si synim që Kolegji Zgjedhor të investohet nga subjekti zgjedhor duke marrë në shqyrtim vendimet e KQZ-së, kur këto vendime cenojnë interesat e ligjshëm të subjektit zgjedhor. Në rastin konkret znj. Dallëndyshe Bici nuk është subjekt zgjedhor.

Në rastin konkret nëpërmjet padisë së paraqitur nga Dallëndyshe Bici, çështja nuk përbën objekt të lëndës së çështjeve që Kolegji mund të marrë në shqyrtim, gjithmonë në interpretim të Kodit Zgjedhor, duke qenë se është rast procedimi administrativ pranë KQZ-së, ndaj personave të tretë. Palët kanë qenë të pranishme në gjykimin e çështjes në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, në përputhje me nenin 156 të Kodit Zgjedhor. Kolegji konstaton mungesë kompetence lëndore dhe disponon pushimin e gjykimit.

***Koment**

⁴³ *Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në kolegjin zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të K.Q.Z-së kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshme brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. Të drejtën e ankimit, sipas këtij neni, e kanë edhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor.*

Ky rast lidhet me interpretimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor në lidhje me ato të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë rast Kolegji nuk mund të vihet në lëvizje në shqyrtimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga pala paditëse, referuar objektit të kërkimeve të saj, që lidhet me kundërshtimin e një vendimmarrje të KAS pranë KQZ, pasi procedura administrative e ndjekur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillimisht dhe më pas Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, i referohet palës në cilësinë e një personi të tretë, jo subjekti zgjedhor. Duke qenë se të drejtën për të bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor e kanë vetëm subjektet zgjedhore, Kolegji nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie.

Armando Subashi kundër Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve & Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisioni Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 21, Dt. 24.05.2023

Çdo mosmarrëveshje tjetër e KQZ-së, që nuk lidhet me këtë proces, por me ushtrimin e funksioneve publike të ngarkuara në Kodin Zgjedhor dhe me ligje të tjera të veçanta, nuk bëjnë pjesë në fushën e kompetencës së KZGJ, por duhet të ankimoheshin në rrugën e zakonshme në gjykatën administrative.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Armando Subashi në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Fier për shfuqizimin e Vendimit nr. (nuk është publikuar dhe njoftuar ende) datë 08.05.2023 të KAS pranë KQZ në lidhje me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Në rastin konkret, pretendimet e palës paditëse lidhen me shfuqizimin e vendimit të KAS mbi vendosjen e sanksionit administrativ gjobë në masën 100,000 lekë.

Z. Subashi nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 24.05.2023. Pavarësisht marrjes dijëni rregullisht, z. Subashi nuk i bëri me dije Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, shkaqe që përligjin mosparaqitjen e tij në seancën gjyqësore. Neni 179 i Kodit të Procedurës Civile i ndryshuar, parashikon pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve që *pa ndonjë shkak të arsyeshem, ... dhe rezulton se kanë dijëni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit*". Kolegji vendosi pushimin e gjykimit të çështjes.

*** Koment**

Njëjtë si në standartin e elaboruar në vendimmarrjet e mëparshme (vendimi nr. 19, dt. 15.05.2023), Kolegji ka interpretuar drejt situatën kur një individ ka dy cilësi, si në rastin e pozicionit të kryetarit të bashkisë i cili ishte gjithashtu në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie, duke përdorur sensibilizimin politik të publikut nëpërmjet faqes së web të bashkisë, duke theksuar që këto publikime kanë pasur qëllim të kryhen në favor të kandidimit të ri. Në rastin konkret, duke qenë se pala paditëse ishte në mungesë, Kolegji e pushoi gjykimin e çështjes.

Gledian Llatja kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr.22, Dt. 24.05.2023

Çështja e paraqitur nga z. Gledian Llatja duhej të ishte pushuar dhe aktet t'i dërgohej për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Gledian Llatja në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Elbasan për ndryshimin e Vendimit nr. 84, datë 08.05.2023 të KAS pranë KQZ-së, për pjesën

që ka të bëjë me vendosjen e sanksionit administrativ ndaj paditësit në masën 100,000 lekë, sipas nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

* **Koment**

Kolegji ka mbajtur të njëjtin qëndrim me vendimin e dhënë për çështjen e ngritur me padi nga Armando Subashi në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Fier. Me qëllim zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të barabarta dhe të ndershme, legjislatori ka parashikuar në Kodin Zgjedhor ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, për të mos krijuar situata favorizuese nga partia e cila ka pushtetin. Në rastin kur subjekti që ngre padinë del në dy cilësi, kolegji ka vlerësuar si kryesore cilësinë si subjekt zgjedhor. Nisur nga ky argument ka analizuar edhe rastin e sanksionit administrativ të dhënë ndaj subjektit zgjedhor.

Gjithashtu, konstatohet si herë e përsëritur, dalja me mendim pakice në çështjet që lidhen me masa administrative me natyrë financiare të dhëna nga KQZ ndaj subjekteve të ndryshme të parashikuar në Kodin Zgjedhor. Duke qenë se ka mendime të pakicës që këto çështje duhet t'i drejtohen për zgjidhje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është e nevojshme të saktësohet në Kodin Zgjedhor llojet e çështjeve që i përkasin procesit zgjedhor të cilat janë në kompetencë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Majlinda Bufi kundër KAS & Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 23, Dt. 24.05.2023

Pushim i çështjes së paraqitur nga kryetaria e Bashkisë Roskovec, me objekt kundërshtimin e sanksionit administrativ nga KAS, për mungesë të kompetencës Lëndore të Kolegjit Zgjedhor dhe dërgimin në kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

* **Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Majlinda Bufi në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Roskovec për shfuqizimin e Vendimit nr. 84 datë 08.05.2023, të KAS pranë KQZ "Për shqyrtimin e kërkesës nr. 21, datë 06.05.2023 të KSHZ", përse i përket vendosjes së sanksionit administrativ, gjobë në masën 100,000 lekë ndaj znj. Bufi.

Paditësja ka marrë dijeni për vendimin e KAS në dt.12.05.2023 dhe kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 19.05.2023. Ajo është legjitimuar si kryetare e Bashkisë Roskovec për të bërë ankim në Kolegji.

Kolegji vendosi pushimin e çështjes dhe dërgimin e saj për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me argumentin se kompetencat e KZGJ-së jo vetëm që nuk përfshijnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lidhen me kundërvajtjet e kryera sipas Kodit Zgjedhor, por KZGJ nuk shqyrton as çështje që kanë ndikim në vijimësinë e një mandati të fituar në zgjedhje, siç janë rastet e vendimeve të KQZ-së për pavlefshmërinë e mandatit të të zgjedhurve, që kanë impakt të drejtpërdrejtë në listat e kandidimit, me të cilat një subjekt zgjedhor ka marrë pjesë në zgjedhje.

* **Koment**

KShH vëren se për këtë çështje, Kolegji ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga zgjidhja që i është dhënë dy çështjeve të tjera me të njëjtin objekt (çështjes me padi të ngritur nga A. Subashi dhe asaj me padi të ngritur nga G. Llatja). Të dyja paditë e fundit janë rrëzuar dhe ka mbetur në fuqi vendimi i KAS, ndërsa për çështjen në fjalë është vendosur pushimi i çështjes dhe

dërgimi i akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë. KShH rithekson qëndrimin e shprehur më herët se është e nevojshme të saktësohen në Kodin Zgjedhor, kategoritë e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë një procesi zgjedhor që i ka kompetencë për t'i shqyrtuar Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.

Safet Gjici kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 24, Dt.24.05.2023

Pushim i çështjes pasi subjekti zgjedhor z. Gjici nuk është paraqitur në gjykim pa shkaqe të justifikuara, duke reflektuar mungesë interesi për gjykimin

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Safet Gjici në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Roskovec për shfuqizimin e Vendimit nr. 85 datë 08.05.2023, të KAS, për pranimin e pjesëshëm të kërkesës ankimore nr. 19 dhe nr. 20, të KSHZ-së përsa i përket vendosjes së sanksionit administrativ, gjobë në masën 100,000 lekë ndaj z. Gjici.

Pala paditëse Safet Gjici në cilësinë e kryetarit të Bashkisë Roskovec është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit. Kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit në datë 22.05.2023. Pala paditëse është njoftuar për vendimin e KAS në datë 17.05.2023.

Z. Gjici nuk u paraqit në seancën gjyqësore të datës 24.05.2023, pavarësisht marrjes dijeni rregullisht, duke mos bërë të ditur shkaqe që përlligjnin mos paraqitjen e tij në seancën gjyqësore. Neni 179 i Kodit të Procedurës Civile i ndryshuar, parashikon pasojat juridike të mosparaqitjes së palëve që *pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ... dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit*". Kolegji vendosi pushimin e çështjes.

*** Koment**

Kur kolegji zgjedhor pushon një çështje për shkak të mungesës së paditësit pa arsytim, standardi i ndjekur zakonisht është se paditësi nuk ka përmbushur barrën e tij të provës ose ka dështuar në ndjekjen administrative të çështjes. Në rastin konkret. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor mund të pushojë çështjen në bazë të këtij standardi, pasi mungesa e paditësit pengon procedimin dhe gjykimin e çështjes në themel.

Partia “Lëvizja e Legalitetit” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi Nr.25 30.05.2023

Kolegji Zgjedhor e gjen padinë të pabazuar në ligj dhe prova, pasi hetimi i kryer nga KAS që përveç procesverbalit për dëmtimin e kutisë së votave ka këqyrur dhe kutinë e votimit është i plotë dhe i pakundërshtueshëm nga Partia “Lëvizja e Legalitetit”.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Partia ‘Lëvizja e Legalitetit’ (PLL) për shfuqizimin e vendimit nr. 125, datë 23.05.2023 marrë nga KAS sipas të cilit rrëzon kërkesën ankimore të këtij subjekti dhe lë në fuqi vendim nr.325, datë 17.05.2023 të KZAZ nr.19 Bashkia Dibër, përsa i përket vlerësimit si të parregullt të kutisë së votave të një QV dhe mos numërimit e saj, pasi është konstatuar e dëmtuar vula e sigurisë gjatë transportit në këtë KZAZ.

Pala paditëse Partia “Lëvizja e Legalitetit” është legjitimuar për të bërë ankim pranë KZGJ, në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Palët kanë qenë të pranishme në gjykimin e çështjes në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, në përputhje me nenin 156 të Kodit Zgjedhor. Kolegji vendosi rrëzimin e padisë.

* **Koment**

Kodi Zgjedhor ka parashikuar një sërë parregullsish, si rrjedhojë e të cilave, kutia e votimit quhet e parregullt.

Rëndësi për të garantuar rregullsinë dhe ligjshmërinë e votimit dhe gjithë procesit që lidhet me të ka edhe marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ. Vula e sigurisë në një kuti votimi luan një rol vendimtar në ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor. Nëse vula e sigurisë është dëmtuar, thyer ose komprometuar në çfarëdo mënyre, ajo mund të ketë disa pasoja, duke ngritur shqetësime për besueshmërinë dhe drejtësinë e zgjedhjeve duke ndikuar në legjitimitetin e perceptuar të rezultateve.

Është kompetencë e KZAZ-së të verifikojë dhe konstatojë parregullsitë në kutitë e votimit, me qëllim ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

Në rastin konkret vendimmarrja e Kolegjit Gjyqësor Zgjedhor është në frymën e parimeve të Kodit Zgjedhor, duke mos legjitimuar ndryshimin e rezultatit të tabelës përmbledhëse të zonës zgjedhore, nëpërmjet rezultatit të fletëve të votimit të gjendura në një kuti votimi të parregullt.

Lefter Maliqi; Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror Zgjedhor

Vendimi Nr. 26, Dt. 07.06.2023

Pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e KAS të bëjë pjesë të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore nr.74, të Lefter Maliqi, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

Studimi i përmbajtjes së vendimit

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Lefter Maliqi dhe koalicionit “Bashkë Fitojmë”, me palë të tretë Partinë Socialiste, për shfuqizimin e pikës 2 të vendimit me nr.136 datë 24.05.2023, të KAS, nëpërmjet të cilit janë rrëzuar për mungesë kompetence katër kërkimet e kërkesës ankimore të paraqitura në ankim. Paditësi ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS. Padia është paraqitur pranë Kolegjit në datë 02.06.2023.

Kolegji Zgjedhor e ka gjetur të legjitimuar palën paditëse dhe këtë e argumentuar nën këndvështrimin e nenit 145, pika 1 dhe nenit 124, pika 1 të Kodit Zgjedhor⁴⁴. Pavarësisht se neni 124, pika 1 nuk përmend si subjekte zgjedhore kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, kjo dispozitë parashikon të drejtën e subjekteve zgjedhore për të ushtruar ankim pranë KQZ (pra, KAS), është interpretuar e lidhur me të drejtën e subjekteve zgjedhore për të ushtruar ankim kundër këtyre vendimeve të KAS, në Kolegjin Zgjedhor sipas nenit 145 të Kodit Zgjedhor.

Nisur nga analiza e fakteve, palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë kanë ngritur pretendime për shkelje të të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe në Kodin e Procedurës Administrative. Vendimi i KAS për mungesë kompetence në lidhje me

⁴⁴ Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

4 kërkimet e kërkesës ankimore ka qenë i paarsyetuar. Për më shumë KAS nuk ka marrë vendim në lidhje me to, gjë që ndikon në ligjshmërinë e procesit të ndjekur në nivel administrativ nga ana e KQZ. Gjatë hetimit gjyqësor është provuar që vendimi i KAS ka qenë i vlefshëm ndryshe nga sa pretendonte pala paditëse, duke evidentuar nënshkrimin e katër anëtarëve të KAS, sipas nenit 21, pika 3 të Kodit Zgjedhor.⁴⁵ Nga ana tjetër respektimi i të drejtave të palëve dhe procedurave përkatëse tregon respektimin e procesit të rregullt ligjor nga ana e gjykatës. Palët kanë qenë të pranishme në gjykimin e çështjes në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, në përputhje me nenin 156 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji vendosi ndër të tjerash pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e KAS të bëjë pjese të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore të palës paditëse, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

* **Koment**

Përgjatë gjyimit të çështjes janë konstatuar vendimmarrje të KAS në kundërshtim me Kodin e Procedurës Administrative si dhe me Kodin Zgjedhor për sa i përket detyrimit për të arsyetuar kërkimet e paraqitura nga subjekti në kërkesën ankimore. Është kompetencë e KQZ që në shqyrtimin e kërkesave ankimore të paraqitura, të marrë në shqyrtim të gjithë problematikën e tyre, përfshirë edhe pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendra të caktuara votimi, pa u kufizuar në objektin e kërkimit të kërkesës ankimore të paraqitur nga subjekti zgjedhor.

Nga ana tjetër, nga ana e KShH konstatohet herë pas herë mos përdorimi i të njëjtës gjuhë juridike në Kodin Zgjedhor kur u referohet subjekteve zgjedhore. Kjo vihet re edhe në nenin 145 i cili i njuh të drejtën e ankimit pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë të gjitha subjekteve zgjedhore, ‘*Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato cenojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi*’ në dallim nga neni 124 pika 1, i cili të krijon përshtypjen e një kufizimi të së drejtës së ankimit në organet administrative zgjedhore. Neni 124, pika 1 i referohet çdo partie politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidatit të propozuar nga zgjedhësit duke lënë pa përmendur **kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore**, të cilët janë parashikuar si subjekte zgjedhore në nenin 2, pika 20 e Kodit Zgjedhor.

Çdo parti politike, pjesëtare ose jo e një koalicioni, dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit kanë të drejtë të ankohen në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, që cenojnë interesat e tyre të ligjshëm, brenda 3 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

Për më shumë, mungesa e terminologjisë së standardizuar dhe harmonizuar përgjatë dispozitave të Kodit Zgjedhor, mund të rezultojë në praktikën e zbatimit të tyre me cenim të të drejtave të palëve të interesuara duke sjellë cenimin e parimit kushtetues të sigurisë juridike. Për rrjedhojë, KShH sugjeron harmonizim të terminologjisë dhe teknikës legjislativë në këto dy dispozita.

Partia Aleanca Progresiste LZHK kundër Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Vendimi Nr.27, Dt.07.06.2023

⁴⁵ **Neni 21 Kodi Zgjedhor** 3. Aktet administrative bazë të KAS-it janë vendimet. Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku tre anëtarë, përveç vendimit sipas shkronjave “a”, “b” ose “c” të pikës 1, kur objekti i ankimit është kundërshtimi i tabelës përmbledhëse për rezultatin e zgjedhjeve në zonën zgjedhore. Në këtë rast vendimi merret kur pro tij votojnë së paku katër anëtarë.

Rrëzimi i padisë, pasi pretendimi për pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre, është i pabazuar në ligj, sa kohë që sipas nenit 161 / 5 e Kodit Zgjedhor, zgjedhjet për këshillat bashkiak nuk përsëriten.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Partia 'Aleanca Progresiste LZHK' për ndryshimin e Vendimit të KAS nr.160 datë 29.05.2023. Në rastin konkret, pretendimet e palës paditëse lidhen me detyrimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të konsideruar të vlefshme kutinë për Këshillin Bashkiak Kurbin, Qendra e Votimit nr. 0907 i cili i përket fshatit Shpërdhet, Njësia Administrative Mamurras, Bashkia Kurbin.

Pala paditëse Partia 'Aleanca Progresiste LZHK' është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. e Kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 05.06.2023.

Palët kanë qenë të pranishme në gjykimin e çështjes në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, në përputhje me nenin 156 të Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Sigurimi i rregullsisë dhe ligjshmërisë së votimit, duke përfshirë edhe transferimin e sigurt të materialeve zgjedhore nga KZAZ, është thelbësore. Integriteti i procesit zgjedhor mbështetet gjithashtu në rregullsinë e kutisë së votimit. Çdo dëmtim i kutisë mund të ketë pasoja të gjera, duke hedhur dyshime mbi besueshmërinë dhe drejtësinë e zgjedhjeve dhe duke ndikuar në legjitimitetin e perceptuar të rezultateve.

Në rastin konkret, vendimmarrja e Kolegjit Gjyqësor Zgjedhor është në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Njëjtë si në vendimmarrjet për çështje me natyrë të ngjashme (trajtuar më sipër), Kolegji thekson mos legjitimitimin e ndryshimit të rezultatit të tabelës përmbledhëse të zonës zgjedhore në bazë të fletëve të votimit të gjetura në një kuti votimi të parregullt. Kjo qasje përforcon angazhimin për ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe ruajtjen e vlerave demokratike.

Kodi Zgjedhur nga ana tjetër ka parashikuar që përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së, që i shpall ato të pavlefshme. Megjithatë Kodi Zgjedhor ka ndaluar përsëritjen e zgjedhjeve për këshillat e qeverisjes vendore. KShH konstaton se ky penalizim që u bëhet zgjedhjeve të anëtarëve të këshillave bashkiakë cenon të drejtën për një proces të rregull dhe të drejtë ligjor.

Koalicioni "Bashkë Fitojmë" & Shkëlqim Hoxha kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 28, Dt. 15.06.2023

Shpallja e pavlefshme e zgjedhjeve në një qendër votimi, kur numri i zgjedhësve të saj është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme, dikton përsëritjen e zgjedhjeve.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Koalicioni "Bashkë Fitojmë" & Shkëlqim Hoxha për ndryshimin e Vendimit nr.174, datë 06.06.2023 të KAS pranë KQZ-së; miratimin e "Tabelës së re përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Rrogozhinë", duke mos përfshirë rezultatit zgjedhor të Qendrës së Votimit Nr.2224/1, Institucioni i Ekzekutimit

të Vendimeve Penale (IEPV) Rrogozhinë, si dhe shpalljen fitues për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, Z. Shkëlqim Hamid Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor “Bashkë Fitojmë”.

Pala paditëse Koalicioni “Bashkë Fitojmë” & Shkëlqim Hoxha është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pranimin pjesërisht të padisë, duke shfuqizuar vendimin nr.174, datë 06.06.2023 të KAS dhe shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023 në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr.43 për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, duke urdhëruar përsëritjen e këtyre zgjedhjeve.

*** Koment**

Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është fokusuar në dy momente kryesore, në të drejtën për të votuar të personave që ekzekutojnë dënimin me burgim me vendim të formës së prerë në një institucion të posaçëm dhe në mënyrën e krijimit të Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV) të posaçme në IEVP (Institucion i Ekzekutimit të Vendimit Penal) Rrogozhinë.

Në lidhje me legjitimitimin e të drejtës së votës së të burgosurve për zgjedhjet vendore, arsytimi i Kolegjit e ka lidhur/kufizuar këtë të drejtë me vendbanimin e të burgosurve. Vendbanimi i zgjedhësve është një nga përbërësit e gjendjes civile dhe pasqyrohen në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për çdo zonë të qendrës së votimit. Vendbanimi i regjistruar në territorin e një prej zonave të qendrave të votimit është kriter përcaktues për përfshirjen e një personi në listën e zgjedhësve.

Lista e zgjedhësve hartohet për çdo zonë qendre votimi dhe përmban të gjithë zgjedhësit që kanë vendbanimin e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në atë zonë qendre votimi.

Kolegji ka marrë në konsideratë dispozitat e Kodit Civil që përcaktojnë vendbanimin dhe vendqëndrimin. Në rastin konkret vendi/institucioni ku të burgosurit qëndrojnë për shkak të vuajtjes së një dënimi, konsiderohet vendqëndrim, të cilin, ndryshe nga vendbanimi, ata nuk kanë të drejtë ta caktojnë lirisht.

Nga ana tjetër, sipas ligjit për gjendjen civile për shtetasit që kryejnë dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale apo qëndrojnë në institucionet e paraburgimit në pritje të vendimit gjyqësor dhe kur qëndrimi në institucionet përkatëse është më i gjatë se tre muaj, vendbanim konsiderohet adresa e institucionit përkatës. Ky ligj parashikon detyrimin e institucionit përgjegjës që të njoftojë zyrën përgjegjëse të gjendjes civile, jo më vonë se 48 orë nga regjistrimi në institucionin i shtetasit. Vendbanimi i shtetasit regjistrohet drejtpërdrejt nga zyra e gjendjes civile që ka në juridiksion territorial IEVP përkatëse, me marrjen e njoftimit nga institucioni.

Kjo do të thotë që përcaktimi i vendbanimit si përbërës zgjedhor bëhet përpara miratimit të listës së zgjedhësve nga organet e qeverisjes vendore. Kjo lidhet me faktin që procedura e kthimit të vendqëndrimit në vendbanim, është e ndryshme nga procedura e miratimit të listës së zgjedhësve për organet e qeverisjes vendore dhe i paraprin asaj.

Gjithashtu kërkesat për ndryshime në përbërësit zgjedhore bëhen jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Këtu përfshihet edhe ndryshimi i kodit të banimit. Pas kësaj faze, shpallet lista e zgjedhësve jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve dhe është e pandryshueshme. Kodi Zgjedhor parashikon që lista e zgjedhësve nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë

shkak pas kalimit të afatit 40 ditë para datës së zgjedhjeve. Përjashtim bën kur zgjedhësi vëren se përbërësi i tij zgjedhor përmban pasaktësi, nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit të vendbanimit të tij ose nuk është regjistruar fare në ndonjë nga listat e njësisë së qeverisjes vendore ku ai ka vendbanimin, duke i lindur e drejta të paraqesë kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor përkatës deri 24 orë përpara datës së zgjedhjeve për të bërë ndryshimet respektive.

Në rastin konkret, të burgosurit e IEVP Rrogozhinë nuk ishin regjistruar brenda 48 orëve në RKGJC nga regjistrimi në IEVP. Për më shumë ata ishin regjistruar duke tejkaluar afatin ligjor jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. **Brenda afatit ligjor për ndryshimin e Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile figuronte vetëm një i burgosur me vendbanim në Rrogozhinë.**

Nga ana tjetër, edhe qendra e votimit në një zonë të veçantë qendre votimi, sikurse është IEVP Rrogozhinë ka disa specifika të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Ajo mund të ngrihet vetëm në rast konfirmimi, në momentin e hartimit të listës së zgjedhësve, të faktit të vuajtjes së dënimit në IEVP Rrogozhinë të 15 zgjedhësve, pra të 15 personave me vendbanim të regjistruar në Bashkinë Rrogozhinë. Mos konfirmimi i krijimit të Komisionit të Qendrës së Votimit (KQV-së) së posaçme në IEVP Rrogozhinë me vendim të KQZ, për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, bën që Qendra e Votimit Nr.2224/1 në IEVP Rrogozhinë të rezultojë e ngritur pa vendim, gjë që përbën shkelje të rëndë ligjore.

Së fundi, Kolegji ka vlerësuar edhe diferencën e votave mes dy kandidatëve për kryetar bashkie në Rrogozhinë. Ka rezultuar që për zgjedhjet për kryetar të qeverisjes vendore, ndikim në rezultat në kuptim të nenit 161, pika 2 të Kodit Zgjedhor do të konsiderohet kur numri i zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme është më i madh se diferenca midis dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave të vlefshme (numri i zgjedhësve në atë qendër votimi të shpallur të pavlefshme ka qenë 118, ndërkohë që diferenca mes dy kandidatëve ka qenë me 21 vota).

Pas analizimit të shkeljeve të konstatuara, Kolegji me të drejtë ka shpallur të pavlefshme zgjedhjet në të gjithë zonën zgjedhore duke qenë se pavlefshmëria e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit të posaçme në Rrogozhinë ndikonte në rezultatin e përgjithshëm të të gjithë zonën zgjedhore.

Në lidhje me rastin konkret konstatohet një shpërndarje e mënyrës së rregullimit të të drejtës për të votuar për të burgosurit në disa ligje. Në këto kushte, krijohen situata komplekse dhe konfuzion në radhët e institucioneve përgjegjëse për t'i zbatuar ato.

Për sa më sipër, përmirësimi i Kodit Zgjedhor, duke bërë plotësimet e nevojshme që shmangin fragmentarizimin e legjislacionit, me synim parashikimin në mënyrë të qartë të realizimit të të drejtës për të votuar të personave që gjenden në institucionet e posaçme, vlerësojmë se do t'i shërbejë parimit të sigurisë juridike, kuptimit të drejtë dhe zbatueshmërisë koherente të dispozitave ligjore.

Paqartësia e dytë vihet re në neni 161, pika 2, fjalia 2 e Kodit Zgjedhor që i referohet konkretisht zgjedhjeve vendore.

Kodi Zgjedhor nuk ka shpjeguar në aspektin e terminologjisë ligjore se çfarë është ndikimi në rezultat për zgjedhjet e kryetarit të qeverisjes vendore dhe pse kjo gjë nuk prek edhe kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë. Së dyti, përmbajtja e kësaj dispozite është e paqartë duke

mos vendosur një masë të caktuar ndërmjet numrit të zgjedhësve në qendrat e shpalluara të pavlefshme dhe diferencës mes dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madhe të votave të vlefshme. Sugjerohet të paraqitet një diferencë konkrete e përcaktuar në marzhe për të mos lënë vend për paqartësi ligjore.

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 29, dt. 15.06.2023

Numri i votueseve të burgosur në IEVP Burgu Kosovë nuk ka ndikuar në ndarjen e mandatit, duke pasur parasysh diferencën e votave midis kandidatit fitues dhe kandidatit të palës paditëse.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, koalicioni “Bashkë Fitojmë” për ndryshimin e vendimit nr. 175, datë 06.06.2023 të KAS në KQZ, duke vendosur:

- a. Rinumërimin dhe rivlerësimin e drejtë të votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore, Bashkia Belsh, si dhe Miratimin e Tabelës Përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh duke përfshirë në të, rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i drejtë i votave;
- b. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 I.E.V.P Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh (me pretendimin se aty kishin votuar persona pa të drejtë vote në këtë bashki);
- c. Ndryshimin e vendimit të KSHZ, nr. 533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke pasqyruar ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetar Bashkia Belsh, duke mospërfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr. 2565/01 IEVP Burgu Kosovë, si dhe shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi mbështetur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Kolegji ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjes së zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar. Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë cenuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provosh se këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se pretendimi i paditësit që shkelja përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata. Kolegji konstatoi se të burgosurit në IEVP e Kosovës e kishin fituar këtë të drejtë nëpërmjet vendimeve gjyqësore të dhëna për secilin prej të burgosurve, nëpërmjet të cilëve u është njohur e drejta për të votuar në QV Nr.2565/01 Burgu Kosovë, sipas nenit 57 të Kodit Zgjedhor.

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 30, dt.19.06.2023

Njëjtë si në vendimin e mësipërm, Kolegji theksoi se shkeljet që mund të kenë ndodhur gjatë votimit, jo domosdoshmërisht pasjellin pavlefshmërinë e tij, duke pasur në vëmendje parimin e proporcionalitetit.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe personi i interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” për ndryshimin e Vendimit nr. 176, datë 07.06.2023 të KAS në KQZ, duke kërkuar:

- a) prishjen e Vendimit të KSHZ nr. 536, datë 20.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Kamëz, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”,
- b) duke vendosur: (i) Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Kamëz; dhe (ii) Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Kamëz me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

Pala paditëse, koalicioni “Bashkë Fitojmë” është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Në mënyrë të ngjashme me standartin e elaboruar në vendimin e analizuar më herët në këtë raport për Bashkinë e Belshit, Kolegji ka theksuar se shpallja e zgjedhjeve të pavlefshme zakonisht përfshin demonstrimin e shkeljeve specifike që minojnë drejtësinë dhe integritetin e procesit zgjedhor. Pretendimet e palëve lidhur me to duhet të mbështeten me prova konkrete. Kolegji ka konkluduar që shkeljet nuk kanë qenë të tilla sa të cënonin rëndë procesin zgjedhor. Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit Zgjedhor konstatohet që vendimmarrja lidhur me shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme është kompetencë e KQZ në nivel administrativ dhe e Kolegjit, të cilët vlerësojnë situatën rast pas rasti. Megjithatë, duke marrë parasysh çështjet që kanë qenë objekt i mosmarrëveshjeve lidhur me pavlefshmërinë rekomandohet që këto dispozita të jenë më të plota sa i përket kategorizimit të shkeljeve të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor, duke sjellë rrjedhimisht pavlefshmërinë e procesit dhe të rezultateve të tij.

Lefter Maliqi kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 31, dt. 20.06.2023

Kolegji vlerësoi se kërrimi objekt padie duhet të shqyrtohej gjatë gjykimit të padisë në themel me objekt “Kundërshtimi i vendimit Nr.178 të KAS”, për aq kohë sa është pjesë integrale e këtij vendimi, dhe jo si një kërkim më vete, në formën e një padie.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Lefter Maliqi dhe personi i interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shfuqizimin e vendimit të KAS për rrëzimin e pikës 1 të ankimit të KAS (KAS) ku ka kërkuar hapjen e kutive për rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ- në Nr. 64, të gjitha QV-të duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

Pala paditëse Lefter Maliqi është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 13.06.2023.

Nisur nga analiza e fakteve, palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë kanë ngritur pretendime për shkelje të të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Pala paditëse ka ngritur pretendimin e cënimit të procesit të rregullt ligjor duke qënë se KAS ka rrëzuar kërkimet e ankuesit, pa dëgjuar të gjitha pretendimet e tij. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pushimin e padisë pasi bazuar në nenin 299 gërma “c” të K.Pr.Civile është vlerësuar se padia nuk mund të ngrihet dhe gjykimi nuk mund të vijojë.

* **Koment**

Duke analizuar dispozitat e Kodit Zgjedhor, vihet re që në Kod është parashikuar rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave përgjatë procedurës ankimuese. Kodi Zgjedhor pranon rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave vetëm për vota të caktuara, si “vota të identifikuara ose të kontestuara”, sipas procedurave të parashikuara në nenet 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar. Kjo lidhet me faktin që numërimi dhe/ose vlerësimi i votave duhet të jenë shoqëruar **me kontestime apo me konstatimin e pasaktësive**, për to duhet të jenë bërë shënime përkatëse në fletët e kontestuara, në tabelën e rezultateve të kontestuar apo në librin e protokollit të KZAZ-së, me qëllim që ato të mund t’i nënshtrohen procedurës së rinumërimit dhe/ose rivlerësimit. Kjo do të thotë që rinumërohen votat e faktuara nëpërmjet provave për pasaktësi, duke mos qënë e parashikuar në Kodin Zgjedhor rinumërimi dhe rivlerësimi i votave automatikisht në të gjithë qendrat e votimit. Kolegji Zgjedhor me të drejtë vendosi pushimin e gjyqimit.

Koalicioni "Bashkë Fitojmë" kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

Vendimi Nr. 32, Dt. 20.06.2023

Kërkimi i palës paditëse për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Elbasan, për shkak të shkeljeve në votimin elektronik, është i pabazuar në ligj, pasi nuk u arrit të vërtetohet se mosplotësimi i njërit prej kushteve teknike të PEVN, cenoi procesin zgjedhor dhe aq më tepër nuk u provua që kjo shkelje të ketë qënë e tillë, sa të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

* **Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe personi i interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” për ndryshimin e Vendimit Nr.177, datë 08.06.2023 (KAS) në KQZ, duke vendosur:

- a. Prishjen e Vendimit të KSHZ Nr.539, datë 20.05.2023⁴⁶,
- b. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan; dhe Përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë si dhe të Këshillit Bashkiak Elbasan me anë të votimit tradicional me fletë votimi fizike.

Pala paditëse koalicioni “Bashkë Fitojmë” është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Padia është paraqitur

⁴⁶ Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në Zonën Zgjedhore Bashkia Elbasan, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023.

pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 12.06.2023. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

*** Koment**

Njëjtë si në standartin e mbajtur për vendimmarrje lidhur me çështje me objekt të ngjashëm, edhe në këtë rast, Kolegji ka evidentuar masën e shkeljes së ligjit, duke konkluduar nëse shkeljet kanë qenë të tilla sa të cënonin rëndë procesin zgjedhor.

Kodi Zgjedhor parashikon në dy dispozita, kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje, si dhe procedurat për futjen e teknologjisë në zgjedhje dhe vendimmarrjes, duke rregulluar mundësinë e parashikimit të rregullave më të detajuara për përdorimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit nga ana e Komisionit Rregullator, pranë KQZ. Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk ka parashikuar në mënyrë të qartë cilat shkelje do të cenonin rëndë procesin zgjedhor, dhe në veçanti shkelje që lidhen me sistemet teknologjike dhe votimin elektronik.

Në vijimin e arsytimit të Kolegjit është evidentuar mundësia e rasteve që zgjedhës të caktuar të kenë gabuar në përdorimin e pajisjes elektronike, gjë që ndikon në zgjedhjen e tyre duke treguar një alternativë që nuk përkon me vullnetin e tyre politik. Megjithatë nuk është vlerësuar në çfarë mase ka qenë ky gabim nga momenti i mosplotësimit të kushteve teknike të PEVN. Përdorimi i sistemeve elektronike duhet të jetë i pajisur gjithmonë me gjurmimin e gabimeve të bëra përgjatë përdorimit të sistemit, me qëllim që të përmirësohen proceset dhe në rastin konkret të mos cenohet integriteti i votimit.

Sa më sipër, duke mbajtur në vëmendje të drejtën e votuesve për të anuluar votimin dhe për të mundësuar konfirmimin e votës së tij, rekomandohet parashikimi në Kodin Zgjedhor i alternativave përkatëse në rast evidentimi të problematikave me votën elektronike ditën e votimit, si dhe përcaktimi i shkeljeve specifike që lidhen me votimin elektronik dhe që cenonin rëndë procesin zgjedhor. Mungesa e rregulloreve dhe standardeve të qarta për sistemet e votimit elektronik mund të kontribuojë në mospërputhje dhe abuzime të mundshme të të drejtës së votës.

Lefter Maliqi & Koalicioni "Bashkë Fitojmë" kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 33, dt. 30.06.2023

Kolegji Zgjedhor vlerëson se vetëm evidentimi i një apo disa parregullsive nuk përbën apriori shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sa kohë që nuk provohet se këto parregullsi kanë cenuar në masë vullnetin e zgjedhësve, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Lefter Maliqi dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe personi i interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shfuqizimin/anullimin dhe/apo konstatimin e pavlefshmërisë absolute tërësore dhe/ose të pjesshme të vendimit nr.178, dt.13.06.2023 të KAS pranë KQZ-së me të cilin është rrëzuar kërkesa ankimore që pala paditëse ka paraqitur për rivlerësimin e votave në të gjitha kutitë, për KZAZ-në 64.

Pala paditëse Lefter Maliqi dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë” është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

Kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 19.06.2023. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi rrëzimin e padisë.

* **Koment**

Kolegji ka argumentuar rastet e pavlefshmërisë së fletëve të votimit, në kontekstin e rasteve të sanksionuara si të tilla në Kodin Zgjedhor, duke mos gjetur raste konkrete që shërbenin si shkak për pavlefshmëri të fletëve të votimit. Kolegji Zgjedhor ka analizuar gjithashtu edhe shkeljen e mos mbajtjes së procesverbalit të dorëzimit të materialeve nga KZAZ në KQV, duke e vlerësuar si parregullsi administrative, për sa kohë që nuk vërtetohet që ka sjellë pasoja në procesin e votimit apo në rezultatin e zgjedhjeve.

Njëjtë si në standartin e elaboruar në vendimmarrjet e mëparshme, për çështje me objekt të njëjtë apo të ngjashëm, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se vetëm evidentimi i një apo disa parregullsive nuk përbën *a priori* shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sa kohë që nuk provohet se këto parregullsi kanë cënuar në masë vullnetin e zgjedhësve, duke cënuar rëndë procesin zgjedhor. Mbi bazën e këtyre argumenteve e ka rrëzuar kërkesëpadinë.

Lidhur me analizën e dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor, parashikimi më i mirë në Kodin Zgjedhor duke evidentur në mënyrë konkrete rastet që çojnë në pavlefshmëri të zgjedhjeve dhe dispozita specifike që përvijojnë rrethanat në të cilat zgjedhjet mund të shpallen të pavlefshme duke i shërbyer integritetit të procesit zgjedhor.

Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 34, dt. 01.09.2023

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor nuk mund të shqyrtojë në themel pretendimet e ankuesit, por vetëm ligjshmërinë e vendimit të shqyrtimit paraprak të ankimit duke vendosur detyrimin e KQZ-së të marrë vendim.

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse Partia Demokratike e Shqipërisë dhe personi i interesuar “Partia e Lirisë” për shfuqizimin e vendimit nr. 179, datë 22.08.2023, të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe detyrimin e KAS, të marrë vendim, lidhur me këtë kërkesë ankimore.

Pala paditëse Partia Demokratike e Shqipërisë është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Më herët, KAS-i ka konkluduar se pala ankuese nuk ka legjitimim për të parashtruar ankim administrativ dhe për këtë arsye ka marrë vendim për mospranimin e ankimit, duke i mohuar palës të drejtën për t’u dëgjuar në lidhje me themelin e pretendimeve të tij. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerësoi se, Partia Demokratike e Shqipërisë ka legjitimim për të kundërshtuar në rrugë administrative vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pasi për efekt të ligjit konsiderohet palë në procedurën administrative mbi bazën e së cilës është dhënë vendimi i KSHZ-së. Kolegji Zgjedhor vlerëson se në rastin konkret, Partia Demokratike e Shqipërisë përveçse **legjitimim formal** që buron nga përmbajtja e nenit 33 të KPA, ka edhe **legjitimim material**, pasi rezulton se ka interes të ligjshëm në paraqitjen e ankimit administrativ.

Nisur nga analiza e fakteve, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka konstatuar se palës ankuese i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në kryerjen e procesit administrativ, duke i

mohuar të drejtën për t'u dëgjuar në lidhje me të gjitha pretendimet e saj, të drejtën për të paraqitur prova, të drejtën për të zhvilluar një procedurë administrative kontradiktore etj.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit KAS, duke e detyruar atë të marrë vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën ankimore të depozituar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, brenda 2 ditëve nga njoftimi i vendimit të arsyetuar.

*** Koment**

Nëpërmjet zgjidhjes së këtij rasti, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka ri konfirmuar qëndrimin për përcaktimin e interesit të ligjshëm për depozitim të një ankimi në rrugë administrative dhe më pas ndjekjen e tij në rrugë gjyqësore. Kolegji ka theksuar kushtet ligjore që provojnë ekzistencën e interesit të ligjshëm të tilla si: identifikimi i aktit që kundërshtohet, cënimi i interesave të ligjshme të subjektit nga ky akt dhe e drejta që kërkohet të rivendoset.

Kolegji ka gjetur me vend mohimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor, i cili përfshin jo vetëm procedurat e ndjekura në procesin gjyqësor por edhe atë administrativ, pasi i ka mohuar palës paditëse të drejtën për t'u dëgjuar në të gjitha pretendimet e saj, të drejtën për të paraqitur prova, të drejtën për të zhvilluar një procedurë administrative kontradiktore etj.

Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Vendimi nr. 35, dt. 15.09.2023

Pranimi i kërkesës së Partisë Demokratike duke konstatuar se e drejta për të propozuar 2 anëtarë të KZAZ-së Nr.11 për zgjedhjet vendore të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, i përket Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe e drejta për të propozuar 1 anëtar të kësaj KZAZ-je i përket Partisë së Lirisë

*** Studimi i përmbajtjes së vendimit**

Çështja lidhet me kërkesën e palës paditëse, Partia Demokratike e Shqipërisë dhe personi i tretë "Partia e Lirisë" për shfuqizimin e vendimit nr. 181, datë 07.09.2023 të KAS "Për rishqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023 të depozituar nga partia politike "Partia Demokratike e Shqipërisë" dhe ndryshimin e vendimit të Komisionerit nr. 722, datë 19.08.2023, duke e ndryshuar në shkronjën "b" dhe "c" të pikës 1 të tij, si më poshtë: b) dy anëtarë propozohen nga "Partia Demokratike" (PDSH); c) një anëtar propozohet nga "Partia e Lirisë" (PL).

Pala paditëse Partia Demokratike e Shqipërisë është legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

Kërkesë padia është paraqitur pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datë 13.09.2023.

Nisur nga analiza e fakteve, palët në procesin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë nuk kanë ngritur pretendime për shkelje të të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Palët, përveç personit të tretë "Partia e Lirisë", kanë qenë të pranishme në gjykimin e çështjes në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, në përputhje me nenin 156 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi pranimin e padisë, sipas objektit të ngritur nga pala paditëse.

*** Koment**

Nëpërmjet këtij vendimi, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor ka saktësuar mënyrën e përlllogaritjes së votave në nivel partie, edhe në rast koalicioni, sa i takon përfaqësimit të tyre në përbërjen e anëtarësisë së KZAZ-së. Në arsyetimin e vendimit evidentohet se Kodi Zgjedhor një sërë të drejtash ia ka atribuar partive politike dhe jo koalicioneve politike. Një nga këto të drejta është e drejta për të zgjedhur anëtarët e KZAZ-ve, duke ja njohur këtë të drejtë partisë kryesore të shumicës parlamentare, partisë kryesore të opozitës parlamentare, partisë së dytë të shumicës parlamentare dhe partisë së dytë të opozitës parlamentare.

Në zgjedhjet vendore, renditja e partive përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare. Kolegji Zgjedhor, duke konstatuar që në rastin konkret të koalicionit, në fletën e votimit përbri emrit të kandidatit mungonte emri i partisë që i përkiste ky kandidat⁴⁷, evidentoi mekanizmin dhe përlllogaritë numrin e votave të fituara në shkallë vendi për Partinë e Lirisë, për ta krahasuar me numrin e votave të fituara nga Partia Demokratike e Shqipërisë. Nga kjo përlllogaritje rezultoi që numri i votave të fituara nga Partia e Lirisë ishte më i vogël se numri që ka fituar subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë” në zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Është e nevojshme të theksohet se si neni 29 ashtu edhe neni 88/3 i Kodit Zgjedhor parashikojnë të drejta që iu takojnë partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit dhe kushtëzohen me numrin e votave të vlefshme të marra prej tyre në shkallë vendi. Nisur nga sa më sipër, rekomandohet të parashikohen në Kodin Zgjedhor dispozita më të qarta në lidhje me organizimin e koalicioneve politike, si organizma hibride, pa personalitet juridik, në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve të koalicionit, duke standardizuar edhe mënyrën e përlllogaritjes së mandateve për subjektet zgjedhore edhe brenda koalicionit politik.

⁴⁷ Neni 67, pika 4, Kodi Zgjedhor

IV. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Duke u bazuar në analizën e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor që kanë qenë objekt i këtij raporti studimor, KShH konkludon si vijon:

- Çështjet janë shqyrtuar nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me trup gjykues të përbërë nga 5 anëtarë në përputhje me nenin 155, pika 2 të Kodit Zgjedhor, të kryesuar nga relatori.
- Subjektet zgjedhore kryesisht kanë qenë të legjitimuara për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Në bazë të nenit 145/1 të KZ të drejtën e ankimit pranë Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, e kanë subjektet zgjedhore dhe individët ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa për regjistrim si subjekt zgjedhor, brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të Kodit Zgjedhor. Në lidhje me mungesën e legjitimitimit mund të përmendim vendimin nr. 5, datë 27.03.2023, ku “Partia Demokratike e Shqipërisë” nuk ka qenë e legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145/1 e Kodit Zgjedhor, për sa kohë që nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor. *[Subjektet që legjitimohen për ankim]*
- Neni 145 i Kodi Zgjedhor i jep subjekteve zgjedhore të drejtën për të bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit në Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato shkelin interesat e tyre të ligjshme brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi. KShH vlerëson se qëndrimi i Kolegjit Zgjedhor është i drejtë sa i takon të drejtës së ankimit që i është njohur subjekteve zgjedhore/partive politike/koalicioneve, të cilët brenda afatit prej 5 ditësh nga shpallja e vendimit të KQZ janë paraqitur në KZGJ, në përputhje me nenin 152, pika 2 të Kodit Zgjedhor. *[Afati për paraqitje ankimi]*
- KShH vëren se vendimet e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor janë dhënë brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesë padisë, në përputhje me nenin 157/2 të KZ.⁴⁸ *[Afati për shpalljen e vendimit]*
- Ankimet në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre në përputhje me nenin 152, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.
- Në shumicën e rasteve palët në proceset e shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadive nuk kanë ngritur pretendime për shkelje të të drejtave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Gjatë hetimit gjyqësor nuk kanë dalë fakte apo prova të reja dhe përfaqësuesit e palëve kanë qenë të pranishëm në gjykimin e çështjes, në përputhje me nenin 156 të Kodit Zgjedhor. Respektimi i të drejtave të palëve dhe procedurave përkatëse tregon respektimin e procesit të rregullt ligjor nga ana e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. *[Procesi i rregullt]*⁴⁹
- KShH vëren se Kolegji Zgjedhor ka respektuar afatet për dhënien e vendimeve, sipas parashikimeve përkatëse të bëra në nenin 157, pika 1 (afati 10 ditor për ankimet ndaj vendimeve që KQZ merr në periudhën 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme

⁴⁸ Neni 157, pika 1 Kodi Zgjedhor “1. Kolegji Zgjedhor gjykon dhe vendos për kërkesëpaditë brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesëpadisë. Në rastet e parashikuara nga fjalia e fundit e pikës 2 të nenit 152 të këtij Kodi, Kolegji Zgjedhor vendos brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankimit.”

⁴⁹ Vendim Nr.1, 23.02.2022; Vendim nr. 1, 09.03.2023

ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje) dhe pika 2 (afati 30 ditor për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe).

- Në vendimin nr. 5, datë 27.03.2023, “Partia Demokratike e Shqipërisë” nuk ka qenë e legjitimuar për të bërë ankim pranë Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në përputhje me nenin 145/1 e Kodit Zgjedhor. Partia Demokratike, me kryetar z. Sali Berisha, për sa kohë që nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor, nuk legjitimohet të kundërshtojë vendimmarrjen e KAS.
- Në vendimin *Ludovik Hasan k. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*⁵⁰ paditësi është gjobitur nga KAS, pa u njoftuar, thirrur dhe dëgjuar në lidhje me shkeljen për të cilën është gjetur përgjegjës. Një proces i tillë administrativ ka cenuar parimin e ligjshmërisë, pasi nuk mund të vendosej një gjobë administrative pa u respektuar parimet e procesit të rregullt ligjor.⁵¹
- KShH vlerëson se si në rastin e vendimit nr. 32, datë 20.06.2023 të KZGJ ashtu edhe në rastin e vendimit nr. 33, datë 30.06.2023, *nuk u arrit të vërtetohet se shkeljet përkatëse kishin arritur të cenonin procesin zgjedhor dhe aq më tepër nuk u provua që shkeljet të ketë qenë e tillë, sa të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve*. Vetëm evidentimi i një apo disa parregullsive nuk përbën apriori shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sa kohë që nuk provohet se këto parregullsi kanë cenuar në masë vullnetin e zgjedhësve, duke cenuar rëndë procesin zgjedhor.⁵²

Paqartësi në Kodin Zgjedhor

- Kodi lidhur me të drejtën e ankimit në gjykatë ka pasaktësi duke përdorur referencë të gabuar ligjore. Konkretisht neni 145, pika 2 e Kodit i referohet shkronjave “a”, “b” “c” dhe “ç” të nenit 24 të Kodit, lidhur me përjashtimin që u lind subjekteve zgjedhore për të bërë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mos marrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja. Në rastin konkret neni 24 nuk përmban shkronjat “a”, “b” “c” dhe “ç”, dispozitë e cila sjell paqartësi ligjore.⁵³
- Në nenin 64 të Kodin Zgjedhor parashikohet që çdo parti politike duhet të paraqesë kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ jo më vonë se 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve, të shoqëruar me dokumentacion respektiv të përcaktuar në germën “b” të këtij neni. Neni nuk parashikon qartësisht se cili është organi kompetent i cili duhet të paraqesë kërkesën. Nga ana tjetër Kodi Civil në dispozitat mbi përfaqësimin e parashikon si mundësi ligjore të drejtën e përfaqësimit nëpërmjet autorizimit për kryerjen e veprimeve të ndryshme juridike. Lidhur me sa më sipër, rekomandohet që të saktësohet organi përkatës në lidhje me paraqitjen e kërkesës për regjistrim të një partie politike si subjekt zgjedhor pranë KQZ, sikundër edhe e drejta e përfaqësimit nga organe të tjera në mungesë të kryetarit të partisë.⁵⁴

⁵⁰ Vendim nr nr. 7, datë 05.04.2023

⁵¹ KAS kishte detyrimin të respektoje parashikimin e nenit 4 pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative ku thuhet se “të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.”

⁵² Lefter Maliqi & Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi nr. 33, 30.06.2023; Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 32 20.06.2023; Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi nr. 29, 15.06.2023; Koalicioni “Bashkë Fitojmë” kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi nr. 30, 19.06.2023

⁵³ Partia Lëvizja e Legalitetit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendim nr. 1, 09.03.2023

⁵⁴ Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 5, datë 27.03.2023

- Neni 65 pika 3 e Kodit Zgjedhor përmend në mënyrë të cekët marrëveshjen e koalicionit ndërmjet subjekteve zgjedhore. Kodi Zgjedhor nuk ndalet për të trajtuar elementët e domosdoshëm të cilat duhet të jenë pjesë e pandashme e çdo marrëveshje koalicioni, si dhe rolin e KQZ në rastin kur marrëveshja e koalicionit figuron të ketë problematika apo pasaktësi në subjektet përkatëse, në objekt, apo edhe në të drejtat dhe detyrimet e palëve. Lidhur me sa më sipër, rekomandohet që të saktësohen në Kodin Zgjedhor elementët e domosdoshëm të marrëveshjes së koalicionit si dhe roli i KQZ në shqyrtimin dhe pranimin e marrëveshjes.⁵⁵
- Neni 70/4 i KZ nuk përcakton përjashtim të pjesshëm nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, i cili do të njihej vetëm si krijimi i komitetit nismëtar dhe jo marrja e firmave mbështetëse. Për më shumë, kandidati është regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019 si kandidat i paraqitur nga një grup zgjedhësish, po në bazë të të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 70 të Kodit Zgjedhor. Duke qenë se neni 70 i KZ nuk ka ndryshuar prej 2012, detyrimi i parashikuar në pikën 3 të nenit 70 të KZ nuk mund të lexohet në dy mënyra të ndryshme. Interpretimi i bërë i këtij neni nëpërmjet Udhëzimit nr. 1, datë 18.01.2023 të Komisionerit Qendror të Zgjedhjeve, duke parashikuar parashikuar procedura që vetë Kodi nuk i sanksionon, cenon parimin e sigurisë juridike duke mos mbrojtur të drejtat e fituara dhe pritshmëritë e ligjshme të subjekteve të të drejtës nëpërmjet të njëjtave dispozita të Kodit. Rekomandohet qartësimi i nenit 70 pika 4 për përjashtimet që i njihen kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë.⁵⁶
- Nisur nga vendimi nr. 13 dhe nr. 14 datë 21.04.2023 të KZGJ objekti i të cilave lidhej me përmbajtjen e fletës së votimit, rekomandohet një disiplinim më i mirë i Kodit Zgjedhor për sa i përket nenit 98 / 3 në lidhje me përmbajtjen e fletëve të votimit. Duke qenë se fjalja e parë e pikës 3 i drejtohet të gjitha subjekteve zgjedhore, përmendja e fjalës “parti” dhe jo subjekt zgjedhor në fjalinë e dytë, të krijon përshtypjen e një përdorimi më të kufizuar se ku do të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë. Për këtë qëllim është e nevojshme të mbahet një terminologji juridike e gjuhësore e njëjtë për subjekte apo objekte të njëjta, me qëllim shmangien e paqartësisë në dispozitat ligjore.
- Duke qenë se shtetasit që dëshirojnë të kandidojnë në zgjedhjet vendore dhe qendrore kryejnë funksione publike me rëndësi të veçantë për jetën politike dhe funksionimin e shtetit, sugjerojmë si të nevojshme parashikimin në Kodin Zgjedhor të të drejtës që mund t’i lindë kujtudo për të raportuar raste të kandidatëve kur ndodhet në kushtet e ndalimit për të kandiduar, në veçanti kur kanë deklaruar të kundërtën në formulari përkatës.
- Pjesa XIV Dispozita të fundit dhe kalimtare, neni 183, pika 8 kushtëzon kompozimin e organeve të administratës zgjedhore dhe të drejtën e propozimit të këtyre anëtarëve në bazë të rezultatit të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe konfigurimit shumicë-pakicë të Kuvendit në çeljen e tij, menjëherë pas këtyre zgjedhjeve. Kjo është një dispozitë kalimtare e miratuar nëpërmjet ndryshimeve që ju bënë Kodit Zgjedhor me

⁵⁵ Partia Demokratike e Shqipërisë kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi Nr.6, datë 30.03.2023

⁵⁶ Mehmet Nelaj kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 8, 11.04.2023

anë të ligjit nr. 101/2020, datë 23.7.2020 dhe që rregullon ngritjen e organeve zgjedhore vetëm për zgjedhjet e ardhshme për Kuvendin (ato të vitit 2021), si dhe për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore (ato të vitit 2023). Në zgjidhje afatgjatë rekomandohet depolitizimi i organeve të administrimit zgjedhor dhe të parashikohet mundësia për të angazhuar individë të trajnuar për të kryer procese të administrimit zgjedhor të pavarur nga subjektet e ndryshme zgjedhore, ose të digjitalizohet procesi i numërimit të votave nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë.

- Në lidhje me të drejtën për të votuar të të burgosurve, konstatohet një shpërndarje e mënyrës së rregullimit të kësaj të drejte në disa ligje. Shpërndarja e zgjidhjes dhe interpretimit të mënyrës së ushtrimit të të drejtës së votimit nga të burgosurit në ligje të ndryshme sjell kompleksitet dhe konfuzion për individët dhe profesionistët ligjorë. Për sa më sipër, rekomandohet përmirësimi i Kodit Zgjedhor, duke bërë plotësimet e nevojshme që shmangin fragmentarizimin e legjislacionit, me synim parashikimin në mënyrë të qartë të realizimit të të drejtës për të votuar të personave që gjenden në institucionet e posaçme. Paqartësia e dytë vihet re në neni 161, pika 2, fjalia 2 e Kodit Zgjedhor që i referohet konkretisht zgjedhjeve vendore. Kodi Zgjedhor nuk ka shpjeguar në aspektin e terminologjisë ligjore se çfarë është ndikimi në rezultat për zgjedhjet e kryetarit të qeverisjes vendore dhe pse kjo gjë nuk prek edhe kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë. Përmbajtja e kësaj pike është e paqartë duke mos vendosur një masë të caktuar ndërmjet numrit të zgjedhësve në qendrat e shpallura të pavlefshme dhe diferencës mes dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madhe të votave të vlefshme. Sugjerohet plotësimi i Kodit Zgjedhor për të parashikuar një diferencë konkrete të përcaktuar në marzhe për të mos lënë vend për paqartësi ligjore.
- Rekomandohet parashikimi në Kodin Zgjedhor i alternativave përkatëse në rast evidentimi të problematikave me votën elektronike ditën e votimit, si dhe përcaktimi i shkeljeve specifike që lidhen me votimin elektronik dhe që cenojnë rëndë procesin zgjedhor. Mungesa e rregulloreve dhe standardeve të qarta për sistemet e votimit elektronik mund të kontribuojë në mospërputhje dhe abuzime të mundshme të të drejtës së votës.⁵⁷
- Është e nevojshme të theksohet se si neni 29 ashtu edhe neni 88/3 i Kodit Zgjedhor parashikojnë të drejta që iu takojnë partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e fundit dhe kushtëzohen me numrin e votave të vlefshme të marra prej tyre në shkallë vendi. Nisur nga sa më sipër, rekomandohet të parashikohen në Kodin Zgjedhor dispozita më të qarta në lidhje me organizimin e koalicioneve politike, si organizma hibride, pa personalitet juridik, duke vendosur masa të qarta mbi mënyrën e përlllogaritjes së mandateve për subjektet zgjedhore edhe brenda koalicionit politik.

Rekomandime për unifikimin e praktikës së KZGJ-së dhe garantimin e një mjeteve efektive ankimi për çështjet zgjedhore

- KShH ka vërejtur standarde të ndryshme në vendimmarrjet e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor^{58,59}. Këto Vendimmarrje nuk i shërbejnë vazhdueshmërisë së dhënies drejtësi

⁵⁷ Koalicioni "Bashkë Fitojmë" kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi Nr. 32 20.06.2023

⁵⁸ Partia Lëvizja e Legalitetit kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendim nr. 1, 09.03.2023; Partia Bindja Demokratike kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi nr. 2, 09.03.2023; Partia Lëvizja për Zhvillimin Kombëtar kundër Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Vendimi Nr. 3, 09.03.2023

⁵⁹ Armando Subashi kundër Komisioni Shtetëror të Zgjedhjeve & Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi nr. 21, 24.05.2023; Gledian Llatja kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Vendimi Nr.22 Datë 24.05.2023

dhe qëndrueshmërisë në zgjidhjen e çështjeve që ndajnë karakteristika ose kanë objekt të ngjashme, duke bërë të mundur që ligji të lexohet dhe të zbatohet në mënyra të ndryshme. KShH, duke u bazuar edhe në diskutimet e mëhershme teknike konsultative me përfaqësues të KQZ dhe KZGJ-së lidhur me draftin paraprak të këtij raporti, vlerëson se harmonizimi i praktikës së Kolegjit Zgjedhor gjyqësor kërkon një trupë të përhershme dhe jo *ad hoc* (gjyqtarët e kolegjit zgjidhen me short, me mandat të kufizuar 4 vjeçar, sipas nenit 146 të Kodit Zgjedhor).

- Vlerësojmë se është e nevojshme të saktësohet në Kodin Zgjedhor gama e mosmarrëveshjeve që lindin gjatë një procesi zgjedhor që i ka kompetencë për t'i shqyrtuar Kolegji Zgjedhor Gjyqësor.
- KShH vëren se disa nga vendimet e KAS kur janë vendosur gjopa administrative, janë kundërshtuar në gjykatën administrative dhe procesi i shqyrtimit të tyre merr kohë, duke humbur efikasitetin e këtij mjeti ankimi. Nëse ato do të ankimoheshin në Kolegj, kohëzgjatja e këtyre proceseve do të ishte e arsyeshme dhe do të përfundonte brenda afatit ligjor 10 ditor. Rrjedhimisht, vlerësojmë se është e rekomandueshme të diskutohet nevoja për zgjerimin e kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe subjekteve që kanë të drejtën e legjitimitetit aktiv për tu ankuar pranë Kolegjit (referuar nenit 145 të Kodit Zgjedhor).
- Gjithashtu, vlen të theksohet se mbrojtja e posaçme që i garantohet gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, sipas nenit 149 të Kodit Zgjedhor krijon privilegje të cilat nuk janë në pajtim me kompetencat që i janë akorduar organeve kushtetuese të pavarura të qeverisjes së gjyqësorit sipas Kushtetutës (147/a dhe 147/d) si dhe parimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit.